EPOKA E RE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5710
E hënë, 25 shkurt 2019
çmimi 0.40 €

Rreth 200 pjesëtarë të komuniteteve joshqiptare kanë aplikuar për ushtarë të Kosovës

FAQE 4-5

Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com
facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR 'EPOKËN E RE', RAGMI MUSTAFA FAQE 4-5

SHQIPTARËT E LUGINËS MBËSHTESIN PLATFORMËN PËR BISEDIME

- Reciprociteti në të drejta do të çojë drejt bashkimit të Luginës me Kosovën

Kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare, Ragmi Mustafa, i ka dhënë mbështetje platformës së Kosovës për dialog me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se në këtë dokument për herë të parë institucionet e Kosovës në mënyrë publike flasin për reciprocitet midis të drejtave të serbëve në Kosovë dhe të drejtave të shqiptarëve në Luginë të Preshevës. Megjithatë, Mustafa ka thënë se reciprociteti në të drejta nuk është zgjidhja fatlume për shqiptarët e Luginës. Sipas tij, reciprociteti në të drejta duhet të dërgojë drejt bashkëngjitjes së Luginës së Preshevës me Kosovën

S'KA BAZË JURIDIKE PËR DIALOGIM DHE DËRGIM TË 'TREPÇËS' NË ARBITRAZH

Ditë më parë Maja Kocijançiq, zëdhënëse e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Federica Mogherinit, ka paralajmëruar se "Trepça" do të diskutohet në dialogun e Brukselit, por u kundërshtua nga përfaqësues të institucioneve të Kosovës. Lidhur me këtë profesori i së drejtës ndërkombëtare, Afrim Hoti, dhe ai i së drejtës ndërkombëtare, Emrush Ujkani, kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se në të drejtën

evropiane dhe ndërkombëtare nuk mund të negociohet e as të dërgohet në arbitrazh pronësia territoriale që i takon një shteti, në këtë rast i "Trepçës" FAQE 3

Kurti kundër idesë për një qeveri gjithëpërfshirëse

FAQE 5

AKTUALE

ÇKA JANË KËTO HARTA NË QARKULLIM? F. 10

Shkruan: Jakup KRASNIQI

KATËR DELEGACIONET E KOSOVËS NË BISEDIMET ME SERBINË, NJË KOMEDI! F. 6

Shkruan: Akademik Rexhep QOSJA



TË HUAJT NË GJERMANI, TË PAZËVENDËSUESHËM F. 11

Nga Mimoza KELMENDI

HOXHAJ PËR TAKSËN: DUHET TË JEMI TË KUJDESSHËM ME PARTNERËT TANË NDËRKOMBËTARË F. 3

EKONOMI

MINISTRIA E BUJQËSISË ENDE PA MINISTËR F. 8

BE-ja KËRKON 3.8 MILIONË PUNËTORË TË KUALIFIKUAR F. 9

SPORT

FERONIKELI TREGON FORCËN NDAJ LLAPIT, PRISHTINA U RIKTHEHET FITOREVE F. 20

'EURONEWS': TURRI I MAJLINDËS DREJT MAJAVE VAZHDON F. 21

RENOVA PUTZ
Maqedoni
Xhepçisht – Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
044/256-051
044/367-061
028/532-617
MITROVICË
STYROKOL · BUNJAKOL · ÇUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjibiznesi.com
info@kolegjibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan , Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Rama: Të hapur për dialog me opozitën

Kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama ka thënë se jemi gjithnjë gati të dialogojmë, të dëgjojmë por sigurisht që duhet edhe të qeverisim pasi ne kemi mazhorancën, jemi përpara në të gjitha sondazhet në mënyrë shembullore

TIRANË, 24 SHKURT - Ne kemi mazhorancën, jemi përpara në të gjitha sondazhet në mënyrë shembullore. Nuk mund të merret peng një komunitet dhe të thuash unë do bëj kamikazin nëse nuk më jepni atë që unë dua. Jemi gjithnjë gati të dialogojmë, të dëgjojmë por sigurisht që duhet edhe të qeverisim.

Kështu deklaroi kryeministri i Shqipërisë, Edi Rama në intervistën e dhënë për televizionin italian RaiNeës, ku flet për protestën e opozitës, djegien e mandateve parlamentare nga ana e saj dhe ecurinë e qeverisjes pas këtyre lëvizjeve.

Sipas kryeministrit Rama, 3-4 orë të protestës së 16 shkurtit rrënuan 3-4 vite në aspektin e imazhit të vendit në sytë e komunitetit ndërkombëtar.

Në lidhje me vlerësimin se komuniteti ndërkombëtar deri në këtë çast e ka kritikuar vendimin për dorëheqje të parlamentarëve të opozitës, duke u rreshtuar pjesërisht me qeverinë tuaj, kryeministri Rama tha se mbështetja është një mirëkuptim për Shqipërinë dhe jo për qeverinë time, sepse ky është një pozicionim i papranueshëm, është një vendim që nuk e di nëse është bërë ndonjëherë në një demokraci parlamentare ku populli përfaqësohet nëpërmjet të zgjedhurve të tij dhe të zgjedhurit e tij duhet t'i përgjigjen vullnetit të popullit.

Në lidhje me deklaratat e këtyre ditëve për një dallim të qartë mes protestave të studentëve të para disa muajve, dhjetorin e kaluar dhe të protestave të këtyre ditëve, të drejtuara nga opozita, Rama thotë se protesta e studentëve ishte një protestë e popullit. Kishin të gjitha arsyet dhe ne i dëgjuam. Ndërsa kjo tani nuk është një protestë e popullit. Kjo tani është një protestë e një establishmenti që u mund rëndë dhe që ka arsye për të protestuar, ngaqë nga njëra anë ata janë të dëshpëruar sepse nuk mund të fitojnë.

Sa u përket kontestimeve të ditëve të fundit që kanë dëmtuar në një farë mënyre imazhin e Shqipërisë në sytë e pjesës tjetër të botës dhe ndoshta e ka bërë më të vështirë rrugën drejt integrimit evropian, Rama thotë se kjo sigurisht që nuk është e mirë për imazhin por edhe për çështjet e vendit, sepse jemi në një periudhë me rritje ekonomike më të madhe se 4%. Ishin 3-4 orë që rrënuan 3-4 vite në aspektin e imazhit.

"Krijuam një qeveri të përbashkët, pikërisht për të pasur zgjedhje që njihen nga të gjithë, por me një kusht, që kush fiton, qeveris dhe kush humbet rri në opozitë, duke hequr dorë nga të folurit keq për Shqipërinë dhe duke kontestuar zgjedhjet. Ne kemi mazhorancën, jemi përpara në të gjitha sondazhet në mënyrë shembullore. Nuk mund të merret peng një komunitet dhe të thuash unë do bëjë kamikazin nëse nuk më jepni atë që unë dua. Jemi gjithnjë gati të dialogojmë, të dëgjojmë por sigurisht që duhet edhe të qeverisim", ka thënë kryeministri Rama.

Mass: Kosova të besojë fort në mbështetjen e Gjermanisë

BERLIN, 24 SHKURT - "Jemi të vendosur ta ndihmojmë Kosovën - dhe këtë ua kemi thënë kolegëve kosovarë javën e kaluar, se ata duhet të besojnë fort në mbështetjen e Gjermanisë". Kështu ka thënë ministri i Jashtëm i Gjermanisë, Heiko Mas për gazetën gjermane "Stuttgarder Nachrichten".

Ai ka thënë se duam perspektivë evropiane për Kosovën, ndërsa reformat, të cilat janë kryer atje, janë mbresëlënëse dhe duhet të pranohen, duke konfirmuar mbështetjen e mëtejme financiare të Gjermanisë për Kosovën.

Mass ka thënë se "Qeveria gjermane e konsideron të gabueshme nëse BE-ja dhe Gjermania heqin dorë nga mbështetja për Kosovën, përfshirë këtu dhe ndihmën financiare. "Po të ndodhë kjo, për një kohë të shkurtër do të shembet e gjitha ajo që është arritur me një mund të madh për një kohë të gjatë", ka thënë Mass.

Edhe pse kanë kaluar 20 vjet pas përfundimi të luftës, në të cilën ishte e angazhuar NATO-ja dhe partnerët e saj në Kosovës, Mass konfirmon edhe më tej vazhdimin e ndihmës financiare të Gjermanisë për këtë vend.

I pyetur lidhur me këtë çështje, ministri Mas ka thënë se "Duam perspektivë evropiane për Ballkanin Perëndimor dhe për Kosovën. Reformat të cilat janë kryer atje, janë mbresëlënëse dhe ato duhet të pranohen".

Mass ka thënë gjithashtu se "e konsideron të gabueshme nëse BE-ja dhe Gjermania heqin dorë nga mbështetja për Kosovën, përfshirë këtu edhe ndihmën financiare. "Po të ndodhë kjo , për një kohë të shkurtër do të shembet e gjithë ajo që është arritur me një mund të madh për një kohë të gjatë", ka theksuar Mass teksa ka shtuar se "Gjermania është e vendosur të ndihmojë Kosovën - dhe këtë ua kemi thënë kolegëve kosovarë javën e kaluar, se ata duhet të besojnë fort në mbështetjen tonë".

Presidencialet, partitë në pushtet po negociojnë në heshtje

SHKUP, 24 SHKURT - Pushteti edhe më tej pa detaje rreth negociatave për një kandidat për president, përveç se ka vullnetin që ai të jetë konsensual. Pasi partnerët e koalicionit dhe Besa nuk u pajtuan, LSDM-ja njoftoi se rezultati do të dihet javën e ardhshme dhe thotë se është mosmirënjohëse të komentohet tani për shkak të seriozitetit të procesit. Ministri i Jashtëm, Nikolla Dimitrov, i cili është ndër emrat e mundshëm për kandidat presidencial, tha se nuk është aq e rëndësishme nga cila pozitë do të jetë kandidati, sa është e rëndësishme figura. Në intervistë ai nuk e theksoi se cili është qëndrimi i BDI-së ndaj tij. 'Mendoj se ka shumë persona cilësorë, sepse është shumë e rëndësishme Qeveria në presidentin e ardhshëm të ketë partner parimor, që ta kapim rrugën dhe të shfrytëzojmë këto vite para nesh që mund të jenë vite të arta, pasi përvoja e shteteve tjera që kanë hyrë në NATO dhe kanë bërë hapa drejt BE-së tregon se këto vite janë vitet e ndryshime dhe zhvillim ekonomik", tha ministri i Jashtëm, Nikolla Dimitrov.

Ende nuk dihet nëse edhe votat e Lëvizjes BESA do të përfundojnë në konton e kandidatit të mundshëm konsensual. Pas bisedimeve me kryeministrin Zaev, kreu i BESË-s, Bilall Kasami tha se mbështetja e tyre nuk do të jetë e pakusht. Kandidati presidencial i VMRO DPMNE-së opozitare, Gordana Siljanovska- Davkova një ditë më parë njoftoi se në kohë rekord janë grumbulluar 10 mijë nënshkrime, me çka edhe zyrtarisht është kandidate për president.

EPOKA E RE

Botohet nga "Epoka e re" • Kryeredaktor: Mal QORRAJ
• Drejtor i përgjithshëm: Sadik ZEQIRI (Tel: 044 127 434, dhe 049 127 434 e-mail: sadikzeqiri@yahoo.com)
• ADRESA: Prishtinë, përballë ish-Selisë Qendrore të UNMIK-ut
• Tel: 038/227-557, e-mail: epokaere_mm@hotmail.com & mm_epokaere@yahoo.com

Me Projektligjin e ri për deklarimin e pasurisë do t'u jepet fund abuzimeve nga zyrtarët e lartë publikë

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 24 SHKURT - Ministri i Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka thënë të dielën se debati për parandalimin e abuzimit, keqpërdorimit, konfliktit të interesit dhe korrupsionit do të marrë fund me Projektligjin e ri për deklarimin e pasurisë, i cili është duke u hartuar nga kjo ministri. "Me vite ka pasur debat nëse sistemi aktual i deklarimit të pasurisë së zyrtarëve të lartë publikë është sistem i duhur dhe nëse misioni i deklarimit të pasurisë është në funksion të parandalimit të abuzimit, keqpërdorimit, konfliktit të interesit dhe korrupsionit. Ky debat do të marrë fund me projektligjin e ri për deklarimin e pasurisë, të cilin jam duke e përgatitur për ta sponsoruar në Kuvend", ka thënë ministri Tahiri.

Ai ka theksuar se deklarimi i pasurisë do të mundësojë edhe verifikimin e të dhënave të zyrtarëve shtetërorë të cilët do ta deklarojnë pasurinë. "Një reformë e thellë është shtruar në këtë projektligj, përmes të cilit po reformojmë secilin aspekt që deri më tani nuk ka funksionuar, duke rritur pritjet dhe përgjegjësitë, duke mundësuar administrim më efikas të të dhënave të deklarimit, duke garantuar zbatim efikas të politikave të reja si dhe duke përmbushur rekomandimet e Bashkimit Evropian. Deklarimi i pasurisë do të ketë mision të qartë, mbështetur edhe me instrumente që e mundësojnë verifikimin e të dhënave", ka pohuar Tahiri.

Më tutje, ministri Tahiri ka thënë se me Projektligjin e ri për deklarimin e pasurisë do të shtohet edhe lista e atyre që do ta deklarojnë pasurinë. "Do të kemi riklasifikim të pozitave që duhet të deklarojnë pasurinë, një listë të re dhe të zgjeruar, jo vetëm nga cilësimi i pozitave të larta publike, por edhe nga cilësimi i secilës pozitë ku ka potencial për abuzim, keqpërdorim të parasë publike dhe konflikt të interesit. Deklarimi i pasurisë, bashkë me evitimin e konfliktit të interesit, do të konstituojnë instrumente jashtëzakonisht të rëndësishme në luftën tonë kundër korrupsionit dhe keqpërdorimit", ka thënë ministri Tahiri.

Hoxhaj për taksën: Duhet të jemi të kujdesshëm me partnerët tanë ndërkombëtarë

PRISHTINË, 24 SHKURT - Zëvendëskryeministri i Kosovës, Enver Hoxhaj, ka treguar për hapat që Kosova po ndjek në bisedimet me Serbinë për çështjen e "korrigjimit të kufijve" dhe strategjinë për të qenë të bashkuar në qëndrim të unifikuar për një marrëveshje të mundshme brenda këtij viti. "Qëndrimi ynë si Qeveri e Kosovës, por edhe si delegacion shtetëror i Kosovës, i mandatuar nga Kuvendi për të negociuar me Serbinë, bashkë me presidentin Thaçi, është që duhet ta kemi një pozicion të përbashkët. Kosova nuk mund të ketë disa pozicione për sa i takon dialogut me Serbinë. Platformën që e kemi hartuar para një jave, e cila do të duhej të miratohej në Kuvendin e Kosovës javën e ardhshme, që do të duhet të siguronte mbështetje të domosdoshme nga deputetët e Kosovës, parasheh që ne duhet të arrijmë njohje të ndërsjellë në mes të Kosovës dhe Serbisë, anëtarësim të Kosovës në OKB, që Kushtetuta e Kosovës,, që buron nga 'Pakti Ahtisari', nuk është diçka që duhet hapur. Në këtë platformë parashihet që territori i Kosovës dhe kufijtë e Kosovës janë të paprekshëm dhe të pacenueshëm. Ky është dokument që ka marrë mbështetje nga subjekte politike të përfaqësuara në këtë delegacion shtetëror. Unë mendoj se ky është pozicioni i Kosovës në dialog", ka thënë Hoxhaj në një intervistë për gazetën "Mapo" në Shqipëri.

Duke folur për taksën ndaj produkteve serbe, ai ka theksuar se kjo taksë ka filluar ta rëndojë raportin e Kosovës në mes të ShBA-së dhe BE-së dhe, sipas tij, është bërë pengesë për dialog. "Taksa mbi mallrat serbe të cilat eksportohen në Kosovë fillimisht ka qenë iniciuar si ide prej arrestimeve. Unë jam ai që i ka hedhur këto koncepte në letër, sepse do të duhet të ketë një taksë në raport me Serbinë, pas një agresioni diplomatik të cilin Serbia e ka bërë mbi Kosovën, në një fushatë agresive, duke bërë përpjekje që të bindë shtete për ta tërhequr njohjen e Kosovës, bllokimin tonë në Interpol dhe qasjet që ka ndjekur Beogradi, që me Kosovën nuk mund të ketë asnjë marrëdhënie normale, bilaterale, politike që duhet ta minonin sovranitetin tonë të brendshëm, që duhet ta pengonin sovranitetin e jashtëm, por që duhet të ketë një raport normal për termat ekonomikë me Kosovën, ose një lloj ekonomie kolonie e Serbisë", ka thënë Hoxhaj.

Ai ka deklaruar se taksa ka qenë një lloj thirrje jo vetëm në raport me Serbinë, por në raport me partnerët tanë ndërkombëtarë për qasjen destruktive të shtetit serb ndaj shtetit të Kosovës. "Taksa ka qenë mesazh. Taksa ka qenë një lloj thirrje jo vetëm në raport me Serbinë, por në raport me partnerët tanë ndërkombëtarë. Dëmi që i është shkaktuar Serbisë në aspektin ekonomik është mbi 100 milionë euro. Kohën e fundit kemi një tjetër situatë. Taksa që kemi vënë në raport me Serbinë, për shkak të kërkesës amerikane dhe evropiane, që të largohet dhe të vazhdojë dialogu, ka filluar ta rëndojë raportin tonë në mes të ShBA-së dhe BE-së dhe është bërë pengesë për dialog. Mendimi im është se duhet të jemi të kujdesshëm në raport me partnerët tanë ndërkombëtarë", ka deklaruar Hoxhaj.

Flet për "Epokën e re", Ragmi Mustafa

Shqiptarët e Luginës mbështe

- Reciprociteti në të drejta do të çojë drejt bashkimit të Luginës me Kosovën

Kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare, Ragmi Mustafa, i ka dhënë mbështetje platformës së Kosovës për dialog me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka thënë se në këtë dokument për herë të parë institucionet e Kosovës në mënyrë publike flasin për reciprocitet midis të drejtave të serbëve në Kosovë dhe të drejtave të shqiptarëve në Luginë të Preshevës. Megjithatë, Mustafa ka thënë se reciprociteti në të drejta nuk është zgjidhja fatlume për shqiptarët e Luginës. Sipas tij, reciprociteti në të drejta duhet të dërgojë drejt bashkëngjitjes së Luginës së Preshevës me Kosovën

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 24 SHKURT - Kryetari i Partisë Demokratike Shqiptare, Ragmi Mustafa, e ka përkrahur platformën për dialog me Serbinë të ekipit shtetëror të Kosovës. Ai ka thënë se përfshirja në këtë platformë e reciprocitetit midis të drejtave të serbëve në Kosovë dhe të drejtave të shqiptarëve në Luginë të Preshevës është veprim i duhur. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Mustafa ka vlerësuar se reciprociteti në të drejta është një pikënisje e cila do të dërgojë drejt bashkëngjitjes së Luginës së Preshevës me Kosovën. "Delegacioni i Republikës së Kosovës në këtë platformë ka paraparë të zbatohet masa e plotë e reciprocitetit midis të drejtave të serbëve në Kosovë dhe të drejtave të shqiptarëve në Luginë të Preshevës. Një gjë e tillë është pranuar edhe nga ndërmjetësit e bisedimeve, përkatësisht Brukseli zyrtar. Mbase kjo është një pikënisje për vazhdimin e dialogut, e cila pikënisje do të çojë pa asnjë dyshim në bashkëngjitjen e Luginës së Preshevës me Kosovën në bazë të referendumit të 22 marsit të vitit 1991", ka thënë Mustafa.

Megjithatë, ai ka deklaruar se reciprociteti në të drejta nuk është zgjidhja e duhur për shqiptarët e kësaj pjesë. Sipas Mustafës, Serbia nuk do t'i respektonte këto të drejta sikurse nuk i ka zbatuar obligimet e mëhershme ndërkombëtare ndaj shqiptarëve. "Nuk besoj se reciprociteti në të drejta do të jetë një zgjidhje fatlume për shqiptarët e Luginës së Preshevës. Nga përvoja që kemi me autoritetet serbe, ato gjithnjë iu bishtnojnë obligimeve të marra nga bashkësia ndërkombëtare, sepse Serbia kishte obligime të caktuara edhe pas luftës së UÇPMB-së", është shprehur Mustafa. Ai ka thënë se ky është momenti i duhur i bashkimit të kësaj pjese me Kosovën.

"Epoka e re": *Z. Mustafa, delegacioni shtetëror i Kosovës për bisedime me Serbinë ka dorëzuar në Kuvend platformën për këto bisedime. Si përfaqësues i Luginës së Preshevës, a jeni konsultuar për këtë dokument?*

Mustafa: Para se ekipi negociator ta dorëzojë në Kuvend platformën për bisedime jemi takuar me zëvendëskryeministrin e Qeverisë së Kosovës, Fatmir Limaj, njëherësh bashkëkryesues i delegacionit shtetëror të Kosovës për bisedime. Me të kemi diskutuar në lidhje me platformën dhe për shumë çështje të tjera. Pa dyshim se përfshija e Luginës së Preshevës në këtë platformë për herë të parë nga institucionet e Kosovës dhe në mënyrë transparente është një hap i mirë. Një vit më parë të flitet për Luginën e Preshevës në këtë proces ka qenë e ndaluar, mbase nga ShBA-ja dhe BE-ja, duke e trajtuar çështjen e Luginës si të ndarë nga çështja e dialogut Kosovë - Serbi.

"Epoka e re": *Çfarë do të thotë për shqiptarët e asaj pjese përfshirja në këtë platformë?*

Mustafa: Kjo është një gjë shumë e mirë që ka ndodhur, sepse delegacioni i Republikës

esin platformën për bisedime

së Kosovës në këtë platformë ka paraparë të zbatohet masa e plotë e reciprocitetit midis të drejtave të serbëve në Kosovë dhe të drejtave të shqiptarëve në Luginë të Preshevës. Një gjë e tillë është pranuar edhe nga ndërmjetësit e bisedimeve, përkatësisht Brukseli zyrtar. Mbase kjo është një pikënisje për vazhdimin e dialogut, e cila do të çojë, pa asnjë dyshim, në bashkëngjitjen e Luginës së Preshevës me Kosovën në bazë të referendumit të 22 marsit të vitit 1991.

"Epoka e re": *Pra, lidershipi i Luginës e përkrah platformën për bisedime?*
Mustafa: Pa dyshim se e përkrahim, sepse deri më tani nga institucionet e Kosovës nuk ka pasur diçka të ngjashme. Tani në mënyrë të hapur dhe para bashkësisë ndërkombëtare institucionet e Kosovës thonë se janë të interesuara për zgjidhjen e statusit politik të shqiptarëve në Luginë të Preshevës, sepse kjo ka qenë e ndaluar gjithmonë. Tani kur kjo po ndodh me siguri me mbështetjen e bashkësisë ndërkombëtare, e veçanërisht të ShBA-së. I gjithë ky proces nis këtu, por do të mbarojë me bashkëngjitjen e Luginës së Preshevës me Republikën e Kosovës.

"Epoka e re": *Çfarë ju bën të jeni optimist se reciprociteti në të drejta do të çojë drejt bashkimit të Luginës me Kosovën?*
Mustafa: Pa dyshim se do të ketë një pikë reference nga duhet të niset çdo proces. Dhe kjo është si një pikë reference nga e cila do të nisë ky proces, sepse tani është momenti më i volitshëm për bashkimin e kësaj pjese me Kosovën dhe çlirimin e shqiptarëve të Preshevës, Medvegjës dhe Bujanocit nga okupimi 100-vjeçar serb.

"Epoka e re": *Në debatin për bashkimin e Luginës me Kosovën kemi pasur edhe disa zëra kritikë të cilët janë shprehur kundër bashkimit të Luginës në këmbim të veriut të Kosovës. Si i keni parë këto qëndrime?*
Mustafa: Janë debate politike për konsumim të brendshëm ditor. Nuk besoj se ka shqiptarë mbi këtë dhe që është kundër bashkimit të shqiptarëve të Luginës me Republikën e Kosovës. Pa dyshim se edhe këta zëra kritikë të disa partive politike apo të institucioneve të caktuara kritike do të ndërrojnë mendje në fund dhe do ta përqafojnë shumë ngrohtë bashkimin e Luginës. Pra, siç e thashë, është momenti që kjo të ndodhë.

"Epoka e re": *Nëse për shkak të rrethanave të caktuara nuk mund të ndodhë bashkimi i Luginës me Republikën e Kosovës, a është reciprociteti në të drejta minimumi që shqiptarët e Luginës mund të pranojnë?*
Mustafa: Nuk besoj se reciprociteti në të drejta do të jetë një zgjidhje fatlume për shqiptarët e Luginës së Preshevës. Nga përvoja që kemi me autoritetet serbe ato gjithnjë iu bishtnojnë obligimeve të marra nga bashkësia ndërkombëtare, sepse Serbia kishte obligime të caktuara edhe pas luftës së UÇPMB-së. Ajo luftë ishte ndërprerë me intervenimin e bashkësisë ndërkombëtare dhe pasi autoritetet e Beogradit ishin zotuar se do të kujdeseshin maksimalisht për të drejtat e shqiptarëve, por ajo nuk ka ndodhur ende. Për këto arsye ne nuk besojmë. Çfarëdo situate që do të ndodhë, ndryshe nga ajo e bashkimit të shqiptarëve të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës me Republikën e Kosovës, nuk do t'i kënaqte shqiptarët e Luginës.

"Epoka e re": *Në Kosovë tani po debatohet shumë rreth taksës që Kosova u ka vendosur produkteve serbe. Sa i ka prekur kjo taksë bizneset shqiptare në atë rajon?*
Mustafa: Natyrisht se disa biznese që veprojnë në Komunën e Preshevës janë prekur, sepse tregu kryesor i tyre ka qenë ai i Kosovës. Megjithatë, ato janë duke e pranuar si sakrificë, sepse për Kosovën e lirë shqiptarët e Luginës kanë sakrifikuar çdoherë, madje edhe jetën e tyre, duke marrë pjesë në luftën e UÇK-së. Ky është një moment i sakrificës me qëllim të forcimit të shtetësisë së Republikës së Kosovës karshi Serbisë.

"Epoka e re": *Tani ShBA-ja po kërkon pezullimin e kësaj takse. Si mendoni se duhet të veprojë Kosova në këtë rast?*
Mustafa: Kjo taksë është mbështetur edhe prej liderishipit të shqiptarëve të Luginës. Pa dyshim se masa prej 100 përqindësh ndaj produkteve serbe ka qenë veprim i duhur ndaj shtetit të Serbisë për shkak të sjelljes që ajo ka bërë në raport me shtetin e Kosovës. Por a duhet të qëndrojë apo jo kjo masë, unë besoj se institucionet e Kosovës do të jenë të gatshme që hapat e saj politikë t'i ndërmarrin në harmoni të plotë me ShBA-në. Meqenëse pjesa dërrmuese e ministrave në Qeverinë e Kosovës janë shqiptarë, atëherë kujtojmë se është një moment kohor ku duhet t'i bindemi ShBA-së. Veprimet e Qeverisë së Kosovës duhet të jenë në harmoni të plotë me Amerikën, sepse ky është aleati më i fuqishëm që kemi dhe i cili ka dhënë kontribut të jashtëzakonshëm për çlirimin e Kosovës.

Kurti kundër idesë për një qeveri gjithëpërfshirëse

Prishtinë, 24 shkurt - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, është shprehur kategorikisht kundër propozimeve për një qeveri gjithëpërfshirëse. Në këtë kontekst, Kurti ka thënë se vendi duhet të shkojë në zgjedhje të reja parlamentare në mënyrë që, sipas tij, t'i hapet rrugë zhvillimit ekonomik, prodhimit dhe punësimit. "Ne të Lëvizjes Vetëvendosje nuk udhëhiqemi nga parashikimet, por nga parimet. Ne dëshirojmë që të ketë sa më parë, për interesin e vendit, zgjedhje të parakohshme parlamentare, zgjedhje demokratike nga të cilat do të dalin institucione me legjitimitet të freskët, edhe qeveri e re, e cila do t'i hapë rrugë zhvillimit ekonomik të vendit që koncentrohet në prodhim dhe punësim dhe te drejtësia institucionale dhe gjyqësore, e cila përqendrohet te luftimi i krimit dhe korrupsionit", ka thënë Kurti për "Ekonomia Online".

Ai ka shtuar se qeveria gjithëpërfshirëse nuk mund ta mbrojë sovranitetin e Kosovës. "Nuk besoj se formulat dhe kombinimet qofshin ato për qeveri teknike apo gjithëpërfshirëse do ta mund ta mbrojnë sovranitetin dhe zhvillojnë ekonominë", ka deklaruar Kurti. Më tutje, Kurti ka thënë se Lëvizja Vetëvendosje me LDK-në janë duke bashkëpunuar për t'i siguruar numrat për rrëzimin e Qeverisë, por që nuk do të mbështesin asnjë iniciativë të Listës Serbe në këtë drejtim. "Lëvizja Vetëvendosje dhe LDK-ja janë partitë më të mëdha në vendin tonë dhe janë parti opozitare që koordinohen brenda Kuvendit dhe jashtë tij. Ne jemi të interesuar që të largohet kjo qeveri dhe të kemi zgjedhje të parakohshme. Natyrisht se ne nuk mbështesim iniciativat që burojnë nga Lista Serbe, por është përshtypja ime që Lista Serbe nuk është e interesuar për rrëzimin e Qeverisë. Ajo është e interesuar për një qeveri të dobët", është shprehur Kurti.
Ai ka thënë se në momentin kur do t'i kenë numrat e nevojshëm do ta rrezojnë qeverinë Haradinaj. "Kur të kemi numrat e domosdoshëm për rrëzimin e qeverisë ne si Vetëvendosje dhe LDK, natyrisht se do ta ndërmarrim një mocion për rrëzimin e qeverisë dhe ne nuk mund të ia imponojmë asnjë deputeti se si do të votojë pavarësisht se prej cilës parti vjen", është shprehur Kurti.
Kurti ka theksuar se qeveria e udhëhequr nga Ramush Haradinaj nuk duhet të rrëzohet për shkak të taksës 100 për qind ndaj mallrave që vijnë nga Serbia, por për shkak të keqqeverisjes. "Kjo është një qeveri e pakicës e cila ka bërë shumë gabime dhe është karakterizuar nga skandale të panumërta, por ndonëse ne angazhohemi për zgjedhje të parakohshme demokratike, ne nuk besojmë se kjo qeveri duhet të rrëzohet për shkak të taksës 100 për qind ndaj mallrave të Serbisë, por për keqqeverisje brenda vendit tonë. Nuk e ka zhvilluar ekonominë. Ne jemi ngulfatur nga deficiti tregtar. Nuk ka punësim për rininë dhe për gratë. Po ashtu, nisi dyfishimin e pagave vetvetes. Pra, kemi nevojë për qeveri të re, për legjitimitet të ri, do të thotë kemi nevojë për zgjedhje të reja demokratike, të parakohshme në Republikën e Kosovës", ka deklaruar Kurti.

KATËR DELEGACIONET E KOSOVËS NË BISEDIMET ME SERBINË, NJË KOMEDI!



Shkruan: Akademik Rexhep QOSJA

1.

Ka një krizë dhe ka shumë paqartësi në bisedimet e filluara tash e sa vjet ndërmjet dy shteteve të cilat para nëntëmbëdhjetë vjetësh ishin në luftë: ndërmjet Serbisë dhe Kosovës.

Në mendjet e përfaqësuesve të këtyre dy shteteve, historia e të cilave është e ngarkuar me shumë drama, tragjedi dhe dhembje të shumëllojshme të mesvetshme, e sidomos me pushtimin serb të Kosovës, me kolonizimin serb të Kosovës, me planet për shpërnguljen e detyrueshme të shqiptarëve në Turqi, me dhunën dhe terrorin e Sigurimit të Brendshëm Shtetëror (UDB-së) mes viteve 1950-1965, me dhunën e terrorin e regjimit të Millosheviqit pas demonstratave të vitit 1981 dhe, mandej, me zhvendosjen e dhunshme të rreth një milion shqiptarëve në vitet 1998-1999, duhet të zotërojë vetëdija për gjendjen e pandryshueshme gjeografike mes tyre: Kosova dhe Serbia janë fqinje dhe do të jenë përgjithmonë shtete fqinje. Në vetëdijen për këtë gjendje duhet të ndikojnë shumë të dhëna, e njëra prej të cilave është: Serbia kurrë nuk do të mund ta çojë Kosovën të themi, në Indonezi, kurse Kosova kurrë nuk do të mund ta çojë Serbinë, të themi, në Australi. Fqinjësia është, pra, fati apo fatkeqësia e tyre e përbashkët. Ky fat apo kjo fatkeqësi duhet të na e mbushë mendjen të gjithëve -shqiptarëve dhe serbëve se duhet të bëhet krejt ç'mund të bëhet, krejt ç'mund të bëhet pa u cenuar interesat shoqërore, kulturore, kombëtare, të përgjithshme, që fqinjësia të bëhet jo fatkeqësi po, në mos jo fat, së paku një gjendje e durueshme, toleruese, ndërsjellshëm e qytetërueshme me kohë, dikur, bashkëpunuese. Dhe, rrjedhimisht, vetëdija për sa u theksua duhet t'ua mbushë mendjen atyre që marrin pjesë në bisedimet midis Prishtinës dhe Beogradit se është mirë të bëjnë çmos që të arrihet marrëveshje me të cilën do të normalizohen marrëdhëniet mes tyre, që të arrihet, më në fund, marrëveshje historike, që do ta përfundojë historinë aq shpesh tragjike mes shqiptarëve e serbëve.

Vetëm ngrirja e marrëdhënieve mes tyre, vetëm ngrirja e marrëdhënieve të sotme mes Kosovës dhe Serbisë, nuk është në dobinë as të Kosovës e as të Serbisë, në mënyrë të veçantë as të Kosovës.

2.

Pjesëmarrja e Prishtinës në bisedimet me Beogradin prej fillimeve nuk ishte pjesëmarrje përkatëse! Pjesëmarrja e Prishtinës në këto bisedime prej fillimeve në të vërtetë ishte pjesëmarrje diletante dhe ishte e tillë, diletante, sepse ishte e privuar prej vetëdijes për përgatitje politike, diplomatike, shtetërore, të përtashme dhe historike. Dëshmi për këtë nuk është vetëm pajtimi për krijimin e Bashkësisë së Komunave Serbe, të cilën me të shpejtë, me shumicën e paragrafëve të saj, do ta rrëzojë Gjykata Kushtetuese e Kosovës. Dëshmitë për këtë janë më të shumta dhe ato janë thënë prej disa juristëve, disa historianëve, disa analistëve, por edhe prej disa prijësve partiakë opozitarë. Dhe kjo nuk është dëshmia e vetme. Edhe trajtimi i çështjes së përcaktimit të kufijve ndërfqinjësorë përfushi, fatkeqësisht, shumë dobësi të përfaqësuesve tonë në bisedimet me Serbinë dhe jo vetëm mosnjohje, papërgatitje, diletantizëm e çka jo tjetër, që si të tilla pashmangshëm se do të sillnin dështim e humbje për ne, siç edhe sollën. Sa e si po tregohet e përgatitur sot Kosova për këto bisedime me Serbinë, që pashmangshëm do të fillojnë, pa shumë vonesë? Në disa pikëpamje po tregohet më mirë e në disa pikëpamje po tregohet dobët si deri sot! Në bisedimet me Beogradin, Prishtina, që deri para disa muajsh nuk kishte fare delegacion të pranuar prej Kuvendit të saj, tani do të marrë pjesë me delegacionin e krijuar prej Kuvendit të Kosovës, që e udhëheqin dy kryetarë! Por, në këto bisedime Prishtina nuk do të marrë pjesë vetëm me këtë delegacion. Jo. Në këto bisedime Prishtina do të marrë pjesë edhe me një delegacion njëanëtarësh, të cilin e kryeson kryetari i Kosovës. Në bisedimet e ardhshme me Beogradin, Prishtina do të marrë pjesë, pra, me dy delegacione dhe me tre kryetarë, të këtyre dy delegacioneve! Delegacionin e ligjshëm, të krijuar prej Kuvendit të Kosovës, e udhëheqin: kryetari i Lëvizja Nisma, Fatmir Limaj, dhe kryetari i Partisë Socialdemokrate, Shpend Ahmeti, kjo domethënë se delegacionin e Kosovës në ato bisedime e udhëheqin përfaqësuesi i partive që përbëjnë Pozitën, në njërën anë, dhe përfaqësuesi i partive që përbejnë Opozitën, në të vërtetë që përbëjnë vetëm pakicën e Opozitës, në anën tjetër! Delegacionin e pazgjedhur në Kuvend, të përbërë prej një anëtari e udhëheq kryetari i Kosovës, që është njëkohësisht anëtar dhe kryetar i këtij delegacioni!

Domethënë: Kosova shtet merr pjesë në bisedimet me Beogradin me dy delegacione, të udhëhequra prej tre kryetarëve, e kjo domethënë me tri delegacione të udhëhequra prej tre kryetarëve të tyre!!! A është parë kund në botë një këso komedie?!

Le të thuhet se një "delegacion" pothuaj të veçantë në bisedimet mes Prishtinës dhe Beogradit e përfaqëson edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, deklaratat e të cilit për Kosovën në bisedime dhe për Kosovën pas bisedimeve janë më mospajtuese, më të forta, më jehuese, në Uashington dhe në Bruksel sesa deklaratat e dy kryetarëve, në të vërtetë të tre kryetarëve të tjerë të delegacioneve: sesa deklaratat e kryetarit të Kosovës, sesa deklaratat e Fatmir Limajt dhe sesa deklaratat e Shpend Ahmetit.

3

Çka mund të presë Prishtina, çka mund të presë Kosova prej përbërjes së tillë të Delegacionit, në të vërtetë të katër delegacioneve të saj? Çka mund të presin Kosova dhe shqiptarët nga ky absurd e nga ky joseriozitet e nga kjo papjekuri shtetërore? E nga kjo komedi? Ndoshta sigurisht më pak të mira e më shumë të këqija. Në këtë Botë, në këtë planet që i thonë Tokë, delegacioni shtetëror, politik dhe diplomatik, pavarësisht sa mund të jenë shtetet e mëdha a të vogla, zakonisht udhëhiqet prej një kryetari. Kështu, prej një kryetari janë udhëhequr dhe udhëhiqen delegacionet shtetërore, politike e diplomatike të ShBA-së, të BE-së, të Rusisë, të Kinës, të Indisë, të Turqisë, të Brazilit, të San Marinos, të Zelandës së Re, të Xhibutit. E të tjera. A mendojnë kryetarët e këtyre delegacioneve të Kosovës, a mendojnë delegatët e Kuvendit të Kosovës, a mendojnë ministrat e shumtë dhe zëvendësministrat edhe më të shumtë të Qeverisë së Kosovës çka e si mendohet për ta, për përfaqësuesit tonë në Bashkimin Evropian, në Shtetet e Bashkuara të Amerikës e kudo tjetër në Botë? Çka mendohet në të vërtetë për institucionet e Kosovës, për Kosovën dhe për shqiptarët?

Po të mendonin nuk do të lejonin që Kosova ta luajë këtë lojë tragjikomike tre-katër ekipore politike, diplomatike, shtetërore, kombëtare në Teatrin e Madh Politik Evropian sot!

Po të mendonin si duhet, çka duhet e sa duhet, nuk do të lejonin që Kosova të punojë kështu siç po punon me katër ekipe delegatësh e kryetarësh me katër-pesë qëndrime kundër vetes!

Të parët, kryetarët e këtyre delegacioneve tona në bisedimet mes Prishtinës e Beogradit, sidomos kryeministri i Qeverisë së Kosovës, Ramush Haradinaj, dhe kryetari i Kosovës, që japin deklarata aq mospajtuese për kushtet në sajë të cilave do të arrihet marrëveshja historike mes Kosovës dhe Serbisë, në të vërtetë mes shqiptarëve dhe serbëve, tregojnë, si u pa, pajtim në prapaskena, në ndeja e gosti të ndryshme netëve të gjata të dimrit.

Por, populli e ka një fjalë të urtë për ata që zihen mes vete Ditën e pajtohen (bashkëpunojnë) Natën, që unë s'po e them këtu se e dinë të gjithë. Kosova duhet të ketë Vetëm një Delegacion dhe Vetëm një Kryetar të këtij delegacioni dhe ky Delegacion me një Kryetar duhet të ketë një Qëndrim për marrëveshjen me delegacionin e Serbisë. Vetëm kështu, me një Delegacion që ka vetëm një Kryetar, që ka vetëm një platformë dhe vetëm një qëndrim të përbashkët, Kosova mund ta përfaqësojë dinjitetshëm Kosovën dhe mund t'i kontribuojë ndryshimit të përfytyrimit të sotëm për të dhe përmirësimit të prestigjit të saj në Botë, sot mjerisht shumë të keqësuar. Vetëkuptohet se përgjegjshmëria politike i privon nga mundësia për të qenë kryetar apo, madje, anëtar i Delegacionit të tanishëm ata që i kanë vendosur: për marrëveshjen mbi krijimin e Bashkësisë së Komunave Serbe, të cilën e shpalli të pavlefshme Gjykata Kushtetuese e Kosovës, për Marrëveshjen mbi demarkacionin me Malin e Zi me të cilën Kosovës i tjetërsohen disa mija hektarë tokë, dhe për pranimin, shpranimin dhe prapë pranimin e Gjykatës Speciale në të cilën dënohen pjesëtarë të UÇK-së!

Qeveria e ardhshme, me më pak ministra e zëvendësministra

PRISHTINË, 24 SHKURT - Qeveria e Kosovës, e udhëhequr nga Ramush Haradinaj, aktualisht ka 21 ministra, tre zëvendëskryeministra dhe 80 zëvendësministra. Të gjithë këta zyrtarë kanë të punësuar edhe numër të madh të këshilltarëve të tyre politikë. Por, një qeveri kaq e madhe për një vend me më pak se dy milionë banorë nuk parashihet të jetë e tillë në mandatin e Qeverisë së ardhshme, pasi kjo çështje pritet të rregullohet me Ligjin për Qeverinë. Përmes këtij ligji ekzekutivi në Kosovë po synon ta ulë numrin e ministrive, përkatësisht ministrave, por edhe të zëvendësministrave.

Kryesuesi i Komisionit për hartimin e Projektligjit, Besnik Tahiri, që njëherësh është edhe Koordinator Nacional për Reforma Shtetërore, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se Ligji për Qeverinë është ligji i dytë më i rëndësishëm për administratën e shtetit, pas miratimit të pakos së reformave shtetërore. Sipas tij, ky ligj e rregullon funksionimin dhe përgjegjësitë e ministrive si dhe trajton aspektin që lidhet me numrin e resorëve.

Në masë të madhe, thekson ai, ligji në fjalë i saktëson detyrat dhe përgjegjësitë e secilit sektor veç e veç. "Ky ligj nuk do të ketë kuptim nëse nuk sanksionohet, nuk vendoset një tavan për numrin e ministrive, që nënkupton që ky ligj detyrimisht do ta bëjë zvogëlimin e ministrive, sikurse që do ta bëjë zvogëlimin e zëvendëskryeministrave dhe zëvendësministrave", ka thënë Tahiri. Ai beson se Ligji për Qeverinë do të kalojë në procedurat e nevojshme në Kuvend në javët në vijim dhe, si i tillë, të miratohet. "Ne kemi mbajtur gjashtë takime të komisionit qeveritar, ku unë jam kryesues. Kemi një draft të ligjit, po ashtu kemi tre raporte të shoqërisë civile, të tre institutëve kryesore që merren me këtë temë. Pastaj do të bëjmë diskutime me partitë parlamentare opozitare për shkak se ky ligj nuk është vetëm për këtë qeveri, por është edhe për qeveritë e tjera që vijnë. Mbi këtë bazë ne jemi të bindur që ky ligj do të jetë ligj jashtëzakonisht i rëndësishëm dhe në funksion të agjendës zhvillimore të vendit", ka deklaruar Tahiri.

Edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka thënë se me këtë ligj nuk po bëhet vetëm zvogëlimi mekanik i numrit të të zgjedhurve, por po bëhet një hap shumë më përpara. Me Ligin për Qeverinë, sipas shefit të ekzekutivit, saktësohet përgjegjësia e secilit. Ligji për Qeverinë është një nga pesë kushtet e Partisë Socialdemokrate për miratimin e buxhetit për vitin 2019, ku ata kërkuan zvogëlimin e numrit të zëvendësministrave.

Shefi i Grupit Parlamentar i Partisë Social Demokrate, Dardan Sejdiu, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se, përveç Ligjit për Administratë Shtetërore, Ligjit për Pagat, duhet të kemi edhe një ligj për Qeverinë. Në këtë formë, sipas Sejdiut, njëherë e përgjithmonë duhet të mbyllen mundësitë që të manipulohet qoftë me paga, qoftë me ministra dhe zëvendësministra. "Pra, që të kemi një sistem në vend, i cili, pavarësisht se kush është kryeministër, nuk mund të abuzojë apo keqpërdor pozicionin për të akomoduar pazare partiake parazgjedhore. Ligji për Qeverinë duhet ta përcaktojë numrin maksimal të ministrave dhe se numri i zëvendësministrave për ministri nuk duhet të jetë më shumë se dy", është shprehur Sejdiu.

Por, deputeti opozitar nga radhët e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ismet Beqiri, ka thënë për "Radion Evropa e Lirë" se ky ligj nuk e ka zanafillën në këtë qeveri. Sipas tij, Ligji për Qeverinë, por edhe Ligji për Pagat, kanë qenë të përgatitura në kohën e qeverisjes së ish-kryeministrit Isa Mustafa. "Kjo është e vërtetë, bile edhe Ligji për Qeverinë ka qenë i bashkëngjitur në kalendarin, gjegjësisht agjendën për Kuvend. Disa ligje që po miratohen më shumë po del të kenë efekt politik dhe elektoral", ka thënë Beqiri, duke shtuar se Ligji për Qeverinë duhet ta prekë së pari qeverinë aktuale.

Dardan Sejdiu nga Partia Socialdemokrate ka thënë se ligji hyn në fuqi në momentin kur votohet në Kuvend. "Vetëm nëse aty përmendet me ndonjë nen që hyn në fuqi pas një kohe të caktuar, por për ne është me interes që të hyjë në fuqi menjëherë, që të reduktojmë këtë qeveri të madhe. Unë besoj se më mirë është të kemi ligj për një çështje sesa të vazhdojë kaosi në administratën shtetërore. Për 18 vjet kemi kaos në organizimin shtetëror dhe nuk besoj se argumenti që me 31 vota mund të shkruhet një ligj i ri është argument valid për të mos e bërë një ligj të mirë sot", ka thënë Sejdiu.

Ndërkaq anëtarë të shoqërisë civile, që vazhdimisht e kanë kritikuar numrin e madh të zëvendësministrave dhe këshilltarëve politikë të ministrave, e vlerësojnë si të qëlluar iniciativën për të bërë Ligjin për Qeverinë, pasi qëllimi kryesor i ligjit është ta kufizojë numrin e ministrave, zëvendësministrave dhe këshilltarëve.

Megjithatë, sipas Isuf Zejnës nga Demokraci Plus, kjo iniciativë ngre dilema në lidhje me nevojën për të pasur këtë ligj, për shkak se aprovohet si ligj i thjeshtë, me një shumicë të thjeshtë në Kuvendin e Kosovës. "Mirëpo dilemat tash janë se një ligj i cili aprovohet me shumicë të thjeshtë atëherë a do të mund t'u rezistojë këtyre tendencave për të bërë qeveri si kjo aktualja me numër shumë të madh të ministrave dhe zëvendësministrave. Kush mund ta ndalë? Një ligj që aprovohet me shumicë të thjeshtë dhe ndryshohet me shumicë të thjeshtë. Kështu që, si i tillë, nuk paraqet kurrfarë garancie që koalicioni i ardhshëm nuk do të ketë numër edhe më të madh të ministrave apo ministrive", ka thënë Zejna.

Zejna ndanë mendimin me deputetin e Lidhjes Demokratike të Kosovës, Ismet Beqiri, se Ligji për Qeverinë duhet të fillojë së zbatuari së pari me Qeverinë Haradinaj. Mirëpo, sipas tij, gjithçka do të varet prej Kuvendit dhe grupit punues. "Aktualisht vullneti është që në dispozitat kalimtare me thanë që ky ligj nuk vlen për këtë mandat të Qeverisë. Mirëpo, nëse ka mundësi që kur projektligji të sillet në Kuvend, të ndryshohet kjo dhe ligji ta obligojë edhe këtë koalicion dhe këtë mandatar të Qeverisë që t'i bëjë reformat e nevojshme, për shkak se në një farë forme është edhe e padrejtë. Të aprovohet një ligj i cili i ndikon vetëm pasardhësit ose qeverinë e ardhshme, por jo edhe mandatin aktual kur qeveria e cila po e sponsorizon këtë ligj, është duke udhëhequr me një numër të ministrave, sidomos zëvendësministrave", ka thënë Zejna.

Përfaqësuesit e shoqërisë civile kanë vlerësuar se këto pozita qeveritare i kushtojnë buxhetit të shtetit të Kosovës deri në tre milionë euro në vit, pasi paga mujore e një zëvendësministri është rreth 1200 euro. 80 zëvendësministrat e Qeverisë Haradinaj do të vazhdojnë të marrin 70 për qind të pagës nga buxheti i shtetit edhe gjashtë muaj pas përfundimit të mandatit.

Rreth 200 pjesëtarë të komuniteteve joshqiptare kanë aplikuar për ushtarë të Kosovës

PRISHTINË, 24 SHKURT - Konkursi i Ministrisë së Mbrojtjes për pranimin e rekrutëve të rinj, ushtarë aktivë të Forcës së Sigurisë së Kosovës, është mbyllur. Në këtë konkurs pritet të pranohen 650 rekrutë të rinj, ndërsa kanë aplikuar mbi 5 000 veta.

Vëllazërim Qerimi nga Zyra për Informim në Komandën e Forcave Tokësore të Kosovës ka thënë për "Ekonomia Online" se nga të dhënat e datës 21 shkurt numri i aplikantëve ka shkuar në 5 000. Qerimi ka theksuar se në këtë konkurs do të pranohen 650 pjesëtarë të cilët do t'i shërbejnë Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK).

Ndërkaq kryeministri Ramush Haradinaj përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka bërë me dije se rreth 200 pjesëtarë të komuniteteve joshqiptare, prej tyre rreth 40 serbë, kanë aplikuar për ushtarë të Kosovës. Ai ka thënë se kjo është shenjë e qartë për integrimin dhe mirëbesimin në Forcën e Sigurisë së Kosovës. "Vullneti i bashkëqytetarëve serbë, që të integrohen në të gjitha strukturat e Kosovës së 17 shkurtit, dëshmon se shantazhit dhe instrumentalizimit të tyre nga Beogradi po i vjen fundi", ka thënë Haradinaj.

S'KA BAZË JURIDIKE PËR DIALOGIM DHE DËRGIM TË 'TREPÇËS' NË ARBITRAZH

Ditë më parë Maja Kocijançiq, zëdhënëse e Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Federica Mogherinit, ka paralajmëruar se "Trepça" do të diskutohet në dialogun e Brukselit, që u kundërshtua nga përfaqësues të institucioneve të Kosovës. Lidhur me këtë profesori i së drejtës ndërkombëtare, Afrim Hoti, dhe ai i së drejtës ndërkombëtare, Emrush Ujkani, kanë thënë për gazetën "Epoka e re" se në të drejtën evropiane dhe ndërkombëtare nuk mund të negociohet e as të dërgohet në arbitrazh pronësia territoriale që i takon një shteti, në këtë rast i "Trepçës"

Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 24 SHKURT - Deklarata e Maja Kocijançiqit, zëdhënëses së Përfaqësueses së Lartë të Bashkimit Evropian për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Federica Mogherini, se për "Trepçën" do të diskutohet në Bruksel në kuadër të dialogut Kosovë - Serbi, ka ngjallur reagime te përfaqësuesit e institucioneve dhe njohësit e fushës së ekonomisë, të cilët kanë theksuar se për pasuritë e Republikës së Kosovës nuk duhet të diskutohet me Serbinë në Bruksel.

Kjo deklaratë e saj dhe mundësia e dërgimit të "Trepçës" në arbitrazh erdhën menjëherë pas miratimit të statutit të "Trepçës" në Kuvendin Kosovës, përmes të cilit është hapur rruga që njësitë thelbësore të kësaj ndërmarrje, që ishte nën menaxhimin e AKP-së, të regjistrohen si pjesë të shoqërisë aksionare "Trepça". Aksionar kryesor i ndërmarrjes së re është Qeveria e Kosovës, ndërkaq 20 për qind të aksioneve u takojnë punëtorëve.

Një pjesë e njësive të "Trepçës" që ndodhen në pjesën e veriut të banuar me serbë të Kosovës, Beogradi zyrtar ka paralajmëruar se nuk do t'i kthehet dialogut pa shfuqizimin e statutit të kësaj ndërmarrje. Rikujtojmë se edhe pas miratimit të Ligjit për "Trepçën" në vitin 2016 pati reagime nga disa firma të Serbisë si "-eleznice Srbije" (Hekurudhat e Serbisë) dhe "Tigar" i Pirotit, si dhe "Elektrokosmet" dhe EPS. Këto firma pretendonin se "Trepça" ua ka borxh 300 milionë euro dhe për këtë arsye, sipas tyre, Ligjin për "Trepçën" do ta dërgojnë në Gjykatën e Arbitrazhit, ndërsa pas kësaj edhe në Odën Tregtare Ndërkombëtare në Paris.

Lidhur me këtë çështje ka folur profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Afrim Hoti. Ai ka thënë për gazetën "Epoka e re" se në të drejtën ndërkom-

Ministria e Bujqësisë ende pa ministër

PRISHTINË, 24 SHKURT - Më 2 shkurt kryeministri Ramush Haradinaj ka liruar nga posti i ministrit të Bujqësisë, Nenad Rikalon, por që nga ajo ditë Qeveria ende nuk ka caktuar ministrin e ri. Javën e kaluar Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor ka mbajtur një takim në të cilin është diskutuar lidhur me mosraportimin e ministrit të Bujqësisë për disa çështje të caktuara. Anëtarët e komisionit u shprehën të shqetësuar për gjendjen në Ministrinë e Bujqësisë, e cila ende nuk ka caktuar ministrin e kësaj ministrie.

Deputetët, anëtarë të këtij komisioni, u pajtuan që përmes një shkrese t'i drejtohen kryeministrit që sa më parë ta caktojë një zëvendësministër për raportim pranë komisionit.

bëtare nuk negociohet e as dialogohet për pronësinë territoriale. "Nuk mund të dërgohet në arbitrazh se kujt i takon 'Trepça'. Në të drejtën ndërkombëtare ne themi 'kur të vendosën kufijtë atëherë konsiderohet që pjesët që janë të lidhura me territorin në mënyrë automatike bëhen pronë e shtetit të ri, shtetit të sapokrijuar'. Që nënkupton se minierat, fabrikat, rrugët, bjeshkët, malet etj.. nuk mund të jenë subjekt i negocimit. Ato janë të lidhura me territorin dhe janë automatikisht pjesë e qeverisjes së vendit", ka deklaruar Hoti.

Ndërkaq sa iu përket aseteve të "Trepçës", si depo, lokale, zyra, pushimore e njësi prodhuese që pretendohet se janë jashtë territorit të Kosovës, ku thuhet se janë 17 astete të tilla që gjiganti metalurgjik i ka kryesisht nëpër vendet e rajonit, profesori i marrëdhënieve ndërkombëtare, Afrim Hoti, ka thënë se astetet jashtë territorit të Kosovës mund të jenë subjekt negocimi me republika përkatëse, por assesi "Trepça" që i përket territorit të Kosovës.

Edhe profesori i së drejtës evropiane, Emrush Ujkani, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se pretendimet e palës serbe që "Trepça" të dërgohet në arbitrazh nuk kanë asnjë bazë ligjore. "Mendoj se nuk ka kurrfarë baze juridike që një çështje që i përket territorit të Kosovës të dërgohet në arbitrazh", u shpreh Ujkani. Sipas tij, në qoftë se "Trepça" shkon në Gjykatën e Arbitrazhit atëherë mund të shkojë edhe krejt Kosova. "Në qoftë se do të shkonte 'Trepça' në arbitrazh atëherë do të duhej të shkojë krejt Kosova në arbitrazh. Pra, i tërë territori i Kosovës. Prandaj është e pakuptimtë të pretendohet një gjë e tillë", ka deklaruar Ujkani.

Kurse sa iu përket aseteve të "Trepçës" në tërë territorin e ish-Jugosllavisë, ai ka thënë se duhet të ketë pajtim në mes shtetesh për këtë çështje. "Pretendimeve që 'Trepça' ka asete nëpër territoret e ish-Jugosllavisë duhet të dakordohemi dhe të arrihet marrëveshje mes shteteve përkatëse me republikat përkatëse. Mbi bazën e një marrëveshje duhet të dihet se kush është trashëgues i aseteve, mirëpo nëse flasim për 'Trepçën' në territorin e Kosovës, kjo s'do koment dhe s'duhet të marrë epilog në Gjykatën e Arbitrazhit", ka deklaruar Ujkani.

Ndërsa Shyqri Sadiku, kryetar i Sindikatës së Punëtorëve në "Trepçë", i cili njëkohësisht është edhe anëtar bordi i kësaj ndërmarrje, ka thënë se assesi s'do të lejojnë që "Trepça" të dërgohet në arbitrazh, duke ritheksuar se në rast se një gjë e tillë do të ndodhë, atëherë do të cenohet sovraniteti i shtetit.

Ai ka paralajmëruar se mund të ketë eskalim të situatës dhe përsëritje të grevave dhe protestave sikurse në vitin 1989. "Në asnjë variant nuk mundet që 'Trepça' të diskutohet në Bruksel. Nëse veç një gjë e tillë mendohet, atëherë besoj se do të ketë trazira, greva dhe protesta në Prishtinë. Nëse bisedohet për 'Trepçën' në Bruksel apo dhe të dërgohet në arbitrazh, atëherë cenohet sovraniteti i vendit. Prandaj mund të them se ne jemi të gatshëm në çdo formë dhe mënyrë ta mbrojmë pronën që na takon. Gjithashtu, nuk e përjashtojmë mundësinë që ta përsërisim situatën e njëjtë si në vitin 1989, pra që të fillojmë me greva dhe protesta, ku edhe mund të eskalojë situata", ka thënë Sadiku për gazetën "Epoka e re".

Gazeta ka provuar që të marrë edhe një qëndrim të shefes së Zyrës së BE-së në Kosovë rreth paralajmërimeve se çështja e "Trepçës" duhet të zgjidhet nëpërmjet marrëveshjes gjithëpërfshirëse për normalizimin e dialogut ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit në Bruksel, mirëpo në përgjigjen e Zyrës së BE-së në Prishtinë është theksuar "që të kontaktohet me zyrën në Bruksel".

BE-ja kërkon 3.8 milionë punëtorë të kualifikuar

Bruksel, 24 shkurt - Bashkimit Evropian i mungojnë rreth 3.8 milionë punëtorë, më së shumti nga fusha e mjekësisë, specialistë dhe punëtorë të kualifikuar nga metalurgjia si dhe teknologjia informative, kanë bërë me dije të dhënat e fundit nga EUROSTAT-i. Më së shumti rreth 1 milion e 200 mijë punëtorë i kërkon Gjermania, ku nga janari i vitit 2020-s do të hyjë në fuqi një mënyrë e thjeshtëzuar e miratimit të vizave gjashtëmujore për ata që duan të kërkojnë punë. Kjo masë u referohet të gjitha vendeve jashtë BE-së, përfshirë Ballkanin Perëndimor.

Krahas Gjermanisë, rreth 821 000 punëtorë të kualifikuar i kërkon Britania e Madhe, pasuar nga Çekia me 271 000, Polonia 156 000, Belgjika 149 000, Austria 126 000, Spanja 125 000, Suedia 103 000 si dhe Hungaria 87 000.

Drejtoria e Inspeksionit dhe policia mbyllin dy barnatore dhe një kazino në Mitrovicë

Mitrovicë, 24 shkurt (ER) - Drejtori i Inspeksionit, Hysni Ahmeti, në bashkëpunim me policinë, kanë kryer kontrolle inspektuese sipas detyrës zyrtare në disa subjekte afariste dhe te lojërat e fatit në rajonin e qytetit të Mitrovicës, ku pas verifikimit janë mbyllur dy barnatore dhe një kazino. Qëllimi i këtyre inspektimeve ka të bëjë me respektimin e orarit të punës nga ato subjekte afariste të cilat zhvillojnë veprimtaritë e tyre pas orës 23:00 dhe zhvillimi i tyre pa licencë.

Drejtoria e Inspeksionit ka njoftuar se këto subjekte afariste janë udhëzuar të pajisen me leje të veçanta për zgjatje të orarit të punës, por të njëjtit nuk e kanë respektuar një gjë të tillë.

Gjatë këtij aksioni janë inspektuar gjithsej dhjetë subjekte afariste, ndërkaq pas inspektimit u konstatua se dy barnatore nuk janë pajisur me leje për zgjatje të orarit të punës në bazë të Rregullores Komunale Nr. 03/2014 për caktim të orarit të punës dhe një kazino për mungesë të licencës. Me këtë rast Drejtoria e Inspeksionit ka marrë masa konform ligjeve në fuqi dhe ka ndaluar përkohësisht zhvillimin e veprimtarive të këtyre subjekteve deri në eliminimin e parregullsive.

I jepet lamtumira e fundit ish-komandantit të UÇK-së, Halim Tolaj

Deçan, 24 shkurt (ER) - Të dielën në Komunën e Deçanit i është dhënë lamtumira e fundit ish-komandantit të UÇK-së, Halim Tolaj nga Prejlepi i Deçanit. Ai është varrosur në kompleksin e varrezave të dëshmorëve të kombit në fshatin Prejlep. Në nderim të veprës së Halim Tolajt, Komuna e Deçanit, e drejtuar nga Bashkim Ramosaj, ka organizuar mbledhje përkujtimore në Sallën e Asamblesë Komunale.

Në varrimin e Halim Tolajt ka marrë pjesë edhe kryeministri i vendit, Ramush Haradinaj. Ai ka thënë se ish-komandanti i UÇK-së, Halim Tolaj, ishte burrë i rrallë që qëndroi i paluhatur në parimet shqiptare. "Jetën e vuri në shërbim të vendit e të lirisë. Pusho i qetë, bashkëluftëtari ynë Halim Tolaj!", ka deklaruar kryeministri Haradinaj.

Ish-bashkëluftëtari i Halim Tolajt, Daut Haradinaj, ka thënë se ka njohur shumë burra të zot në luftë, por të rrallë ishin ata si Halim Tolaj. "Do të kujtoj gjithmonë sikurse të kam njohur në vijat e luftës, kreshnik burrë", ka thënë deputeti i Kuvendit të Kosovës, Daut Haradinaj.

Muharremaj synon që Suhareka të bëhet komuna më e pastër në Kosovë

Suharekë, 24 shkurt (ER) - Kryetari i Komunës së Suharekës, Bali Muharremaj, ka bërë me dije se komuna që drejton është duke u marrë në vazhdimësi me pastrimin e ambientit nga mbeturinat. Muharremaj ka thënë se nuk do të ndalen deri në krijimin e një ambienti të pastër në tërë territorin e Komunës së Suharekës. "Ne nuk ndalemi asnjë ditë që të punojmë deri në realizimin e synimit tonë, që Komuna e Suharekës të jetë me ambientin më të pastër në Kosovë", ka thënë Muharremaj.



Mbahet Olimpiada e Matematikës në Gjilan

Gjilan, 24 shkurt (ER) - Nën përkujdesjen e Drejtorisë Komunale të Arsimit në Gjilan ka filluar të mbahet Olimpiada e Matematikës, ku po marrin pjesë mbi 100 nxënës të klasave IX, X, XI dhe XII.

Drejtori i kësaj drejtorie, Nazim Gagica, ka deklaruar se Gjilani vazhdon të jetë shembull i organizimit cilësor të olimpiadave matematike. Ai ka falënderuar kryetarin Lutfi Haziri për mbështetjen e madhe që po i jep sektorit të arsimit, duke shtuar se falë përkrahjes së tij Gjilani po vazhdon të jetë shembull i suksesit në këtë aspekt.

Në këtë olimpiadë nga klasat e IX-ta fitues kanë dalë: Lum Jerliu dhe Yllkë Jashari nga Shkolla Fillore "Thimi Mitko" dhe Elda Qerimi nga Shkolla Fillore "Agim Ramadani", ndërsa nga klasat e X-ta fitues kanë dalë: Rinesa Morina, Edini Rama, dhe Dion Miftari nga Gjimnazi Natyror "Xhavit Ahmeti". Kurse nga klasat XI dhe XII fitues kanë dalë: Vegim Ibrahimi, Bardh Mustafa, Samir Bunjaku, Albinis Rudaku, Laurë Jahiu dhe Drilon Morina nga Gjimnazi Natyror "Xhavit Ahmeti".

ÇKA JANË KËTO HARTA NË QARKULLIM?

- Çfarë mesazhi përcjellin këto?

Shkruan: Jakup KRASNIQI

Disa harta e një draft marrëveshje me disa pika po qarkullon në portale e rrjete sociale. Disa nga pikat kyçe të draft-marrëveshjes së propozuara të "traktatit të miqësisë dhe fqinjësisë së mirë" ndërmjet Serbisë dhe Kosovës.

Për hartën (hartat) më së miri, mendimin e tij e ka shprehur politologu ynë i njohur Bardhyl Mahmuti, i cili thotë: "Prezantimi i hartës është bërë me mjeshtri që të krijohet iluzioni se në këtë shkëmbim territoresh gjoja Kosova fiton më shumë se Serbia! Këtu kemi të bëjmë me një manipulim të fëlliqtë në funksion të krijimit të një klime të favorshme për t'i dhënë territoret e Kosovës Serbisë dhe për të 'marrë' territoret që padrejtësisht janë ndarë prej saj".

Sigurisht, jo vetëm hartat janë mashtrim, mashtrim është edhe teksti që i përcjell hartat dhe ku krijohet përshtypja se Serbia po humbet territor dhe Kosova po fiton territor. Po kush është ai i marrë që i beson kësaj përralle? Jo, 1 001 herë jo, kjo marrëveshje nuk është duke u bërë për ta bërë më të madhe Kosovën, por për ta kënaqur Serbinë. Por, mos të flasim as për këtë, por të flasim si i kemi punët mes vete? Këtu e shoh unë problemin kryesor.

Si po na gjen kjo marrëveshje?

Kushdo që në muajt e fundit, e veçmas ditët e fundit, i ka përcjellë me vëmendje zhvillimet politike, e sidomos debatet politike në mes të partive politike në përgjithësi, por edhe ato në mes të koalicionit qeverisës e partive opozitare në veçanti, nuk ka si mos të jenë të zhgënjyer. Të zhgënjyer jo vetëm për nivelin kulturor të debatit, përmbajtjen dhe kulturën e komunikimit për çdo çështje. Zhgënjimi më i madh është se edhe për çështjen më vitale të interesit kombëtar nuk kemi ndonjë kulturë e përgjegjësi komunikimi me seriozitet. Nuk kemi përgjegjësi as për marrëveshjen politike me Serbinë e disponuar shumë armiqësisht ndaj vendit tonë e kombit përgjithësisht, por nuk jemi duke menduar për sigurinë në nivelin gjithëkombëtar.

Në situata të tilla, kur priten kthesa të mëdha që mund të përcillen me rreziqe të shumta, përgjegjësitë e institucioneve të shteteve tona do të duhej ta arrinin unitetin e mendimit dhe të veprimit. Po, cila është gjendja reale në këto çështje të mëdha? Gjendja është, ashtu si do ta dëshironin armiqtë tanë! Jemi krejt të çakorduar. A të gjithë e dimë se as çiftelia që i ka vetëm dy tela pa e akorduar, këngëtari nuk mund të këndojë.

Atëherë çka duhet bërë?

Kështu si jemi, është si të shkosh në mal pa sëpatë, mbase edhe më keq. Në një situatë të çoroditur politike brenda vendit e kombit (e kam parasysh gjendjen në Kosovë e në Shqipëri), dialogun me Serbinë duhet lënë për kohë më të mira.

Së pari, duhet ta normalizojmë komunikimin brendapërbrenda koalicionit parazgjedhor, i cili lë për të dëshiruar shumë;

Së dyti, duhet ta sjellim në kufirin normal komunikimin në mes partive të koalicionit qeverisës me ato opozitare, i cili është krejt i zymtë, dhe

Së treti, duhet ta formësojmë dialogun në nivelin gjithëkombëtar sa herë që është në pyetje siguria e gjithë shqiptarëve në Gadishullin Ilirik. Për këtë çështje nuk kujdeset askush?!

Kur ta arrijmë komunikimin normal e të përgjegjshëm brenda kombit, atëherë mund të themi se jemi të gatshëm ta zhvillojmë dialogun për marrëveshje finale me Serbinë e cila, pa dyshim, është kundërshtari ynë dyshekullor, së paku që nga koha e Garashaninit (1844).

Krejt në fund. Dialogun nuk bën t'ia varim në qafë e as t'ia besojmë asnjë individi, cilido qoftë ai. Sa herë që për çështjet tona madhore kanë vendosur individët, fati tragjik për kombit ka vazhduar. Mos të lejojmë të na përsëritet e ditura paraprakisht! Kështu do të duhej të ishte, sa jemi është diçka tjetër!

Mos të mbjellim iluzione ne njisha e me njisha të çakorduar!

TË HUAJT NË GJERMANI, TË PAZËVENDËSUESHËM

Nga Mimoza KELMENDI

Dekada më parë ekonomia gjermane lulëzonte, por vendi kërkonte forca punëtore. Republika Federale kishte nënshkruar që në vitin 1955 marrëveshje punësimi me Italinë, më pas me Spanjën, Greqinë, Turqinë, Portugalinë dhe, në vitin 1968, me Jugosllavinë. Të ashtuquajturën marrëveshje për punësim Gjermania e nënshkroi me Turqinë më 30 tetor 1961. Ndërsa më 12 tetor 1968 Gjermania nënshkroi Marrëveshjen për Tërheqjen e Fuqisë Punëtore me ish-Jugosllavinë socialiste, marrëveshja për "gastarbeiter". Në mesin e të cilëve edhe shumë shqiptarë nga Kosova. Fillimisht ata e konsideronin veten si "punëtorë emigrantë të përkohshëm" dhe donin vetëm të fitonin për ca kohë para jashtë atdheut dhe të ktheheshin. Por më vonë e kuptuan se "e përkohshmja" ishte bërë e "përhershme". Pra shumë prej tyre erdhën për një vit, por qëndruan një jetë. Me kalimin e kohës ata e kuptuan se do të ishte më mirë të jetonin në Gjermani, madje edhe duke sjellë më vonë gratë dhe fëmijët e tyre. Gjenerata e dytë dhe e tretë sot (pra fëmijët dhe nipat e mbesat e tyre) përpiqen ta ruajnë identitetin e tyre kombëtar, edhe pse brezi më i ri flet ndërkohë më mirë gjermanisht se sa shqip.

Nëse brezi i parë i punëtorëve emigrantë e vlerësonte me prioritet identitetin shqiptar, brezi i dytë dhe për më tepër ai i treti e shikojnë identitetin shqiptar të barasvlefshëm me identitetin gjerman. "Punëtorët e përkohshëm", kështu ishte përcaktimi zyrtar, punonin ditën shumë, ndërsa në darkë dilnin në klubet e tyre të sapoformuara. Nga këndvështrimi i sotëm mund të thuhet se ata jetonin që atëherë në një shoqëri paralele. Natyrisht se vetë shqiptarët tregojnë se nuk janë patjetër të asimiluar, por janë shumë mirë të integruar. Sepse në këta 50 vjet kanë ndryshuar jo vetëm emigrantët, por edhe shoqëria gjermane. Madje shkrimtari Max Frisch pati deklaruar në atë kohë: "Në kërkuam fuqi punëtore, por erdhën njerëz".

Ndërkohë në Gjermani jeton brezi i dytë dhe i tretë (madje edhe i katërt) i shqiptarëve të ardhur si "gastarbeiter". Numri i tyre llogaritet mbi 300 000 veta. Por pas vitit 1991, me fillimin e Luftës në Jugosllavinë e Millosheviqit, mijëra shqiptarë nga Kosova u vendosën në Gjermani. Sot flitet që numri i gjithë shqiptarëve ka arritur mbi 600 000. Shumë syresh kanë edhe pasaportën gjermane. Ndërsa emigrimi nga Shqipëria ishte dikur një vendim shumë i rëndësishëm për jetën, sepse në kohën e komunizmit largimi qe rrugë pa kthim.

Sipas një studimi të kryer nga Zyra Shqiptare e Statistikave (INSTAT), Gjermania ishte në vitet 1990-1995, pas Italisë, destinacioni më i preferuar i emigrantëve shqiptarë nga Shqipëria. Zyra Federale Gjermane e Statistikave ka regjistruar në vitin 1990, 3 298 emigrantë shqiptarë. Ndërmjet viteve 1992 dhe 2010 në Gjermani kanë ardhur mesatarisht rreth 10 000 - 12 000 emigrantët shqiptarë në vit. Në vitin 2011 ishin rreth 10.300.

Aktualisht në Gjermani po vijnë gjithnjë e më shumë shqiptarë për të studiuar dhe punuar. Sipas të dhënave të EUROSTAT-it me mbi një milion emigrantë në vendet e BE-së, Shqipëria zë vendin e tretë në klasifikimin e emigrantëve sipas vendit të origjinës. Një rol të madh luan edhe imazhi negativ i Shqipërisë apo Kosovës jashtë që i tremb shumë veta të kthehen përsëri në vendin e tyre.

Shumë shpesh janë prindërit që i këshillojnë fëmijët të mos kthehen, sepse janë të zhgënjyer vetë me situatën e tyre. Madje tani vendit po i kthejnë shpinën aq shumë veta si kurrë më parë. Dhe nuk është çudi, që edhe njerëz me kualifikim të lartë largohen tashmë nga Shqipëria apo Kosova, për ta nisur jetën nga e para jashtë vendit. Fjala është për mjekë, infermierë, inxhinierë, ekspertë të ekonomisë, informaticientë, teknikë e tjerë. Por a mundet tashmë Gjermania pa të huaj?

Fakt është që ndërkohë Gjermania është bërë strehë për migrantët. Më shumë akoma. Ata janë bërë të pazëvendësueshëm, siç vërtetojnë shumë fakte. Me të drejtë shtrojnë pyetjen ekspertë të ndryshëm të demografisë: Ç'do të ndodhte sikur të gjithë migrantët pa pasaporta gjermane (pra rreth 8 për qind) të largoheshin papritur nga Gjermania? "Nuk do të kishte asnjë pjesë të jetës, që nuk do të ishte e prekur", përgjigjet gazetari Pitt von Bebenburg, autor i librit "Gjermania pa të huaj". "Një gjë e tillë do të ndikonte në mënyrën më dramatike mbi zonat me përqendrim të lartë popullsie". Shembull në metropolin e Hessenit, Frankfurt mbi Main, i cili do të humbiste 25 për qind të banorëve të vet.

Mbi 4 milionë të huaj ushtrojnë në Gjermani një profesion. Ata punojnë në të gjitha fushat e punës dhe të ekonomisë. Por Gastronomia ka shkallën më të lartë të të huajve, me 20 për qind. Po qe se të huajt do të largoheshin nga vendi, shumë gjermanë duhet të heqin dorë nga gjëra të ndryshme, sepse dyneri turk ia ka zënë prej vitesh vendin currywurst-it gjerman, (salsiçes me erëza djegëse), si vakti i vogël më i pëlqyer. 122 000 tonë mish dyneri hahet në vit aktualisht në Gjermani ose mbi 2 milionë porcione në ditë.

Por merita e migrantëve për Gjermaninë shkon përtej shifrave të tregut të punës dhe qebapëve apo dynerëve. Migrantët kanë dhënë një kontribut të madh. Ata kanë punuar në sektorin industrial dhe kanë kontribuar shumë në hovin e ekonomisë gjermane. Migrantët japin këtu, edhe për shkak të kompetencave të tyre ndërkulturore, një kontribut shumë të vlefshëm. Falë migrantëve, multikulturaliteti duket se po kthehet në normalitet për një numër gjithnjë në rritje gjermanësh, ndër të tjera 1,8 milion raste lidhjesh martesore mes gjermanëve dhe të huajve.

Që Gjermania ka nevojë për emigrantë është tashmë e padiskutueshme edhe për faktin se gjermanët kanë pak fëmijë dhe kështu sistemi social dhe i pensioneve po bëhet financiarisht i papërballueshëm, por edhe sepse mungojnë specialistë.

Pompeo: Ditët e Nicolas Maduro janë të numëruara

Uashington, 24 shkurt - Sekretari amerikan i Shtetit theksoi të dielën se fundi është pranë për Nicolas Maduro dhe se ShBA-ja nuk e njeh më si president të Venezuelës. "Jam i bindur se falë venezuelasve ditët e Maduros janë të numëruara", deklaroi sekretari i Shtetit, Mike Pompeo. "Ne shpresojmë fuqishëm që në ditët, javët dhe muajt e ardhshëm regjimi i Maduros do të kuptojë se populli venezuelas ka mundësuar që ditët e tij të jenë të numëruara", ka deklaruar Mike Pompeo.

I pyetur për një ndërhyrje të mundshme të forcave të armatosura amerikane, ai qëndroi konform me linjën e mbajtur që prej fillimit të krizës nga Uashingtoni duke mos e refuzuar këtë mundësi. "Ne kemi thënë që të gjitha mundësitë janë në tavolinë. Ne do të bëjmë atë që duhet, që demokracia të mbretërojë dhe që një e ardhme më e mirë të krijohet për venezuelasit", tha Pompeo.

Guaido: Duhet t'i shqyrtojmë të gjitha mundësitë për ta çliruar Venezuelën

Udhëheqësi opozitar venezuelas Juan Guaido, president i përkohshëm i Venezuelës, tha se "ngjarjet e këtyre ditëve më detyrojnë të vendos t'i propozoj bashkësisë ndërkombëtare se duhet t'i lëmë hapur të gjitha mundësitë për ta siguruar lirinë për vendin tim"

Karakas, 24 shkurt - Të paktën katër civilë u vranë të shtunën pasi që forcat e sigurisë së Venezuelës u përleshën me demonstruesit në kufirin me Brazilin për shkak të ndihmave humanitare. "Ngjarjet e sotme më detyrojnë që të vendos t'i propozoj bashkësisë ndërkombëtare se duhet t'i lëmë hapur të gjitha mundësitë për ta siguruar lirinë për vendin tim", shkroi të shtunën vonë në rrjetet sociale, udhëheqësi opozitar venezuelas, Juan Guaido, president i përkohshëm i Venezuelës.

Po të shtunën vonë nënpresidenti amerikan Mike Pence publikoi planet për ta takuar Guaidon sot (e hënë) në Bogota. Nënpresidenti Pence pritet t'i drejtohet Grupit Lima, të udhëheqësve rajonalë në Kolumbi sot (e hënë), ku edhe do të takohet me Guaido. Ai mund të shpallë atje edhe sanksionet e reja ndaj regjimit në Venezuelë.

"Foro Penal" (Forumi Penal), një grup që vëzhgon dhunën në Venezuelë, raportoi për katër të vdekur të shtunën. Sipas grupit, ata u vranë nga anëtarët e milicisë proqeveritare në Santa Elena de Uairen, afër kufirit me Brazilin.

Zëdhënësi i grupit, Alfred Romero, postoi edhe një video në "Twitter", duke theksuar se më shumë se një duzinë janë plagosur gjatë dhunës.

Në një pikë kufitare, një kamion ndihmash mori flakë dhe turma u hodh në përpjekje për t'i shpëtuar pakot me ushqime dhe pajisje mjekësore.

Të shtunën vonë, senatori amerikan Marco Rubio shkroi në "Twitter" se një ligjvënës venezuelas dhe ndihmësi i tij janë helmuar. Ndihmësi vdiq, sipas postimit të senatorit, ndërsa ligjvënësi është "në gjendje të rëndë".

Zyrtarët e Kolumbisë thanë se më shumës se 60 ushtarë venezuelas dezertuan të shtunën.

Majori i Ushtrisë së Venezuelës, Hugo Parra, shpalli dezertimin të shtunën, duke i thënë VOA Noticias se ai e njeh udhëheqësin e opozitës Juan Guaido president të ligjshëm të Venezuelës.

Juan Guaido mirëpriti veprimet e ushtarëve në një shkrim në "Twitter". "Ata nuk janë dezertorë. Ata vendosën të vihen në anën e popullit dhe kushtetutës", tha ai.

Presidenti i diskutueshëm, Nicolas Maduro, shpalli në një fjalim, para mbështetësve të tij të shtunën, se do t'i presë lidhjet diplomatike me Kolumbinë. Presidenti i Kolumbisë, Ivan Duque, u paraqit së bashku me Guaido të shtunën derisa po punonin për të dërguar ndihma në Venezuelë.

Presidenti Duque tha se ambasadorët dhe konsujt e Kolumbisë kanë 24 orë afat për t'u larguar nga Venezuela.

Ministri i Jashtëm i Kolumbisë, Carlos Holms Trujillo, lëshoi një deklaratë në të cilën thuhet se "Kolumbia e mban përgjegjës uzurpatorin Maduro për çfarëdo sulmi apo shkeljeje të të drejtave të zyrtarëve kolumbianë në Venezuelë".

Maduro tha, po ashtu, se do ta mbrojë pavarësinë e Venezuelës me jetën e tij. Ai e cilësoi Guaidon si kukull të Shtëpisë së Bardhë. Ai tha se nëse Shtetet e Bashkuara e sulmojnë vendin e tij, "do të përballen me fuqinë e forcave të armatosura të Venezuelës".

Ndërkohë, presidenti amerikan Donald Trump shprehu mbështetjen ndaj Guaido.

Më herët, të shtunën, Juan Guaido, deklaroi se ngarkesa e parë e ndihmës humanitare ka arritur në Venezuelë nga kufiri i saj jugor me Brazilin. "Kjo është një arritje e madhe, Venezuela!", shkruante Guaido në "Twitter" të shtunën.

Një zyrtar i Departamentit të Shtetit që po udhëton me autokolonën e ndihmës i tha "Zërit të Amerikës" se ngarkesa me ushqim dhe artikuj mjekësorë nga Qeveria amerikane dhe ajo braziliane ishte mbajtur në një bazë ushtarake në Bao Vista të Brazilit.

Në qytetin Urena pati përplasje të shtunën gjatë ditës mes trupave të Gardës Kombëtare venezuelase dhe banorëve që po zhbllokonin një urë që lidh Venezuelën me Kolumbinë për ta lejuar ndihmën humanitare të hynte në Venezuelë nga Kolumbia.

Mueller: Manafort ka shkelur ligjin disa herë me radhë

Uashington, 24 shkurt - Zyra e këshilltarit të posaçëm, Robert Mueller, i ka thënë një gjyqtari amerikan se udhëheqësi i fushatës së presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, Paul Manafort, e ka thyer ligjin disa herë dhe nuk meriton "zbutje" gjatë gjykimit. Ky rekomandim erdhi pas seancës dëgjimore të Manafortit që u bë publike më 23 shkurt.

Mueller është duke hetuar rolin e Rusisë në zgjedhjet presidenciale në ShBA më 2016 si dhe bashkëpunimin e mundshëm të ish-udhëheqësit të fushatës me Moskën. Trumpi kishte kundërshtuar të gjitha akuzat si dhe Moska ka kundërshtuar ndërhyrjen në zgjedhjet në ShBA.

Së paku 34 persona kanë pranuar fajësinë apo janë paditur në lidhje me hetimet e Muellerit. Manafort, po ashtu, akuzohet për shpëlarje të parave dhe konspiracion apo manipulim me dëshmitarët e rastit.

BeyAb for bread

Risi, tani BEYAB-in mund ta gjeni edhe nëpër dyqanet e Kosovës. BeyAb është prodhim turk, dhe përpos tregut në Shqipëri e Mal të Zi tani edhe në Kosovë.

11 femrat më të pasura në botën e teknologjisë

Dagmar Dolby

Judy Faulkner

Meg Whitman

Zhou Qunfei

Zeng Fangqin

Në listën e miliardereve që kanë arritur sukses falë industrisë së teknologjisë ka emra shumë të famshëm dhe të tjerë pothuajse të panjohur.

Laurene Powell Jobs

Edhe në botën e teknologjisë numri i grave miliardere është shumë më i ulët se ai i burrave. Kjo konfirmohet nga renditja e fundit e prezantuar nga 'Business Insider', e cila shqyrton të dhënat e publikuara në revistën Forbes. Sajti amerikan vë në pah 11 gratë më të pasura në botë dhe në vend të parë është listuar sipërmarrësja dhe filantropja Laurene Powell Jobs, e veja e themeluesit të Apple, i cili mburret me një pasuri të 18500000000 $ (ekuivalente me rreth 16, 2 miliardë euro). 55-vjeçarja është kreu i Laurene Powell Jobs Trust, një fond që zotëron miliona aksione në Apple dhe Walt Disney. Gjithashtu ka themeluar Kolektivin Emerson, një kompani që kontrollon revistën amerikane 'The Atlantic'.

Dagmar Dolby

Në vendin e dytë është amerikania Dagmar Dolby me 4.2 miliardë dollarë (baras me rreth 3.6 miliardë euro). 77-vjeçarja është aksionerja më e madhe e Dolby Laboratories, një kompani amerikane që zhvillon teknologjinë audio. Në total ajo zotëron rreth 38% të kompanisë

Laurene Powell Jobs

që bashkëshorti i saj, i cili vdiq gjashtë vjet më parë, themeloi në vitin 1965.

Judy Faulkner

Në një shkallë më të ulët të podiumit është Judy Faulkner, themeluese dhe administratore e deleguar e 'Epic Systems', kompani farmaceutike që shet mallra sanitare. 75-vjeçarja e ka filluar nga zeroja në vitin 1975 dhe ndërtoi një kompani inovative dhe unike që shumë shpejt fitoi aksione të mëdha në treg. Sot asetet e saj arrijnë në 3.8 miliardë dollarë (të barabartë me 3.1 miliardë euro).

Meg Whitman

Pozicioni i katërt shkon për amerikanen Meg Whitman, në të kaluarën administratore e deleguar e Heëlett Packard Enterprise dhe eBay. Që nga prilli 2018, është emëruar në krye të Quibi, i cili prodhon mini-seri televizive që mund të ndiqen në smartphones. Asetet e saj arrijnë 3.5 miliardë dollarë (2.9 miliardë euro).

Zhou Qunfei

Në vend të pestë në listë është kinezja Zhou Qunfei, e cila ka pasuri prej 3.9 miliardë dollarësh (2.7 miliardë euro). E lindur e varfër në një qytet të vogël në provincën e Hunnan Kinës, 49-vjeçarja deri 16 vjet më parë ishte një punëtore në një fabrikë orësh me një pagë mujore pak më shumë se njëqind dollarë në muaj. Pika e kthesës ishte në vitin 2003, kur hapi me 3.000 dollarë, Lens Technology në Hong Kong, një kompani e specializuar në ekranet dhe lentet optike. Në pak vite, ajo ka arritur të marrë kontrata me kompanitë më të rëndësishme në botë të tilla si Apple, Samsung dhe Motorola dhe tani punëson 80.000 punëtorë në shtatë kompani.

Zeng Fangqin

Vijon në listë 53-vjeçarja kineze Zeng Fangqin, presidente e Lingyi Technology, një kompani që ofron komponentë elektronike për smartphone, tableta dhe laptopë për kompanitë e mëdha ndërkombëtare të tilla si Huaëei dhe Apple. Asetet e saj arrijnë 2.9 miliardë dollarë (2.3 miliardë euro).

Ma Dongmin

Në vend të shtatë është kinezja Ma Dongmin, gruaja e Robin Li, bashkëthemelues dhe i CEO të Baidu. Që nga viti 2017, ajo ka qenë ndihmësja e veçantë e bashkëshortit të saj, president i motorit kryesor të kërkimit të ish-Perandorisë Qiellore. Zotëron një pasuri prej 2.6 miliardë dollarë (2 miliardë euro).

Lam Wai Ying

Vijon më tej Lam Wai Ying, presidente dhe bashkëpronare e Biel Crystal, një kompani që prodhon touch për iPhone dhe produkte të tjera të teknologjisë, duke përfshirë tabletën dhe smartëatch. Pasuria e saj vlerësohet në 2.3 miliardë dollarë (rreth 2 miliardë euro).

Thai Lee

Më tej, amerikania Thai Lee, me një pasuri totale prej 2.1 miliardë dollarë (1.4 miliard euro), është në të njëjtin nivel. 60-vjeçarja është kreu i SHI International, një ofrues i shërbimeve dhe produkteve me bazë në New Jersey. Kompania ka mbi 17,000 klientë, përfshirë AT&T dhe Boeing.

Wang Laichun

Pozicioni i radhës është për kinezen Wang Laichun, presidente e Luxshare precize, një kompani që prodhon lidhje elektronike për kompanitë si Apple. 51-vjeçarja gjithashtu ka punuar për Foxconn në të kaluarën. Asetet e saj ndalen në 2.1 miliardë dollarë (1.7 miliardë euro).

Sheryl Sandberg

Mbyll 'top 11' Sheryl Sandberg, numri 2 i "Facebook" dhe drejtoresha aktuale operative e rrjetit social. 49-vjeçarja, e cila më parë kishte pozitën e zëvendëspresidentes për shitje online në Google, ka një pasuri prej 1.6 miliardë dollarësh (1.4 miliardë euro). *Gazeta Shqip*

Ma Dongmin

Lam Wai Ying

Thai Lee

Wang Laichun

Sheryl Sandberg

Kendra Wilkinson ndahet zyrtarisht nga burri

Kendra Wilkinson dhe Hank Baskett janë zyrtarisht të ndarë. Një gjyqtar miratoi divorcin e tyre disa muaj pasi u refuzua për gabimet klerike, raporton "TMZ". Ish-çifti, i cili u martua në vitin 2009, do ta ndajë kujdestarinë e dy fëmijëve të tyre. Përpjekja e tyre e mëparshme për ta marrë përfundimin e divorcit të tyre kishte ngecur kur juridiksioni dhe data e gabuar u dhanë në dokumente dhe një seksion tjetër nuk ishte plotësuar plotësisht. Ata e rishkruan në janar.

Selena Gomezi, e lumtur për martesën e shoqes së ngushtë

Selena Gomez u pa shumë e lumtur në martesën e shoqes së saj të ngushtë. 26-vjeçarja u pa e veshur me një fustan të zi dhe me një pamje tërheqëse. Ndër shokët e shumtë të Gomezit, e pranishme ishte edhe këngëtarja e "Slow Hands", Niall Horan, e cila ka qenë një shoqe e ngushtë për Selenën për vite me radhë. Në dasmë u lëshuan edhe disa këngë të saj me të cilat vallëzuan miqtë e përbashkët të saj.

Amy Schumer anulon turneun

Amy Schumer ka anuluar pjesën e mbetur të turneut. Aktorja 37-vjeçare, e cila është shtatzënë, ka njoftuar përmes "Instagram"-it se ajo po përballet me disa komplikime dhe kjo është arsyeja e anulimit. "Për shkak të disa komplikimeve nuk mund të jem pjesë e turneut tim. Fëmija dhe unë jemi mirë dhe çdo gjë duket mirë, por jam në tremujorin tim dhe kam ende të përziera gjatë gjithë kohës dhe të vjella", ka shkruar Schumer.

Aktorja e njohur tregon si i humbi 13 kilogramë

Sherri Shepherd ka zbuluar se si i humbi 13 kilogramë. "Unë kurrë nuk kam ndarë fotografi për të treguar trupin tim pa rroba, por dua ta ndajë me ju se si jam dukur dhjetë muaj më parë dhe përparimin që kam bërë që nga prilli i vitit të kaluar", ka shkruar aktorja në "Instagram" së bashku me fotografitë para dhe pas në udhëtimin e saj të humbjes së peshës. Aktorja 51-vjeçare zbuloi se ajo peshonte 85 kilogramë në vitin 2018 dhe tani ajo është në mes të 72-73 kilogramëve. "Vetëm dua t'ju inkurajoj që të merrni hapa drejt shëndetit tuaj, më shumë ujë, më shumë gjumë, ushtrim, meditim, lutje, falje, më pak sheqer, një vit", ka shkruar Sherri Shepherd.

Heronjtë e një kohe që kurrë

KOMANDANT NEXHMI KRASNIQI- 'SKIFTERI 500'- I ÇMUAR NË LUFTË E NË PAQE ME VEPRIMET GJITHKOMBËTARE PËR TË MIRAT E KREJT ATDHEUT

Në vitet 1998-1999, Komandant i Policisë Ushtarake të UÇK, Zona Operative e Pashtrikut, sot drejtor i Policisë Rajonale në Prizren, z. Nexhmi Krasniqi gëzon autoritet dhe nder të veçantë midis popullatës, te të gjitha moshat, kategoritë dhe profesionet... I gjithë autoriteti i komandantit, " Skifteri 500" është krijuar nga veprimtaria e tij atdhetare dhe guximtare për shumë vjet, por kurorëzimi i kësaj vlere respekti e nderi për Nexhin buron nga veprimtaria e tij trimërore, atdhetare e çlirimtare, si njëri nga eprorët më të suksesshëm në gjithë Republikën e Kosovës, gjatë veprimit në Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës...

Shkruan: AFRIM MUSTAFA, Reporter dhe Veteran i luftërave të UÇK-së

Malisheva është nga rajonet, i cili dha kontribut të çmuar për fitoren e Lirisë dhe Pavarësisë së Republikës së Kosovës...Qindra djem e vasha nga kjo trevë kosovare iu përgjigjën Kushtrimit në Luftën e Lavdishme të të Pavdekshmes, Ushtria Çlirimtare e Kosovës... Njëri nga ata, i cili kontribuoi personalisht dhe familjarisht në të Lavdishmen dhe Kullëçeliken e Përjetshme, UÇK, është edhe komandanti i mirënjohur dhe njëri nga themeltarët e lavdisë në këto treva, Nexhmi Krasniqi, në luftë i njohur me nofkën trimërore, " Skifteri 500"... Nexhmiu udhëhoqi me plot guxim, trimëri e sukses Policinë Ushtrarake të UÇK-së, Zona Operative e Pashtrikut, ku dha kontribut qysh në themelimin e këtij organizmi çlirimtar, por edhe në rritën, zhvillimin dhe forcimin e Forcës së Përjetshme çlirimtare të Atdheut tonë lavdiplotë... I lindur në lagjen, "Lahovitë", në fshatin Tërpezë të Malishevës prindërit e Nexhmiut, nënëloke: Shefkija dhe baba Isaku, ishin ata, të cilët trimit i dhanë edukatë dhe moral të lartë, pasi familja e bacës Isak, prore shquhej për atdhedashuri, mikpritje, traditë dhe bukëdhënie për të njohur e të panjohur... Familja Krasniqi nëpër dedada po kundërshtonte regjimet sllavokomuniste, duke kritikuar publikisht ish-pushtetet për veprimet e tyre antinjerëzore dhe antishqiptare. Se, Nexhmi Krasniqi ishte kundërshtar i ish-regjimit sllav dëshmon edhe veprimtaria e tij thellësisht atdhetare dhe në moshë të re, kur si nxënës i shkollës së mesme në Kijevë arrestohet dhe burgoset për pjesëmarrje në demonstratat e Pranverës së Vitit 1981, si dhe për bashkëveprim me bashkorganizatorët dhe bashkëveprimtarët e këtyre nismave pranverore atdhetare: Azem Syla, Gani Krasniqi dhe ndonjë tjetër... Nexhmiu, në burg u mbajt disa ditë, ku u rrah, u torturua dhe u maltretua për orë dhe ditë të tëra... Në arrestimin e atdhetarit marrin pjesë shumë policë, midis të cilëve edhe disa ish- udbashë, të cilët gjatë basitsjes gjejnë edhe literaturë dhe libra kombëtarë nga Shqipëra...

Kujtim dhe Nderim nga Lufta e Lavdishme e UÇK-së: Nga e djathta- lartë: Afrim Buçaj , Ismet Jashari- Kumanova, Imer Alushani- Vogëlushi, Habib Zogaj. Ulur: Nga e djathta: Refki Mazreku (Vandami) Çerkin Dugolli, Nexhmi Krasniqi , Naser Shala. Luzhnicë, qershor 1998

Lufta e UÇK-së: Në të djathtë:.Çerkin Dugolli , Imer Alushani , Habib Zogaj, Nexhmi Krasniqi, Naser Shala. Ulur: Bajram Shala. Tërpezë-Malishevë, qershor, 1998

Nëna Shefkije, ish-regjimlinjve dhe udbashëve sllavokomunistë: " Jeni si çetnikët serbë, por kurrë nuk do të arrini ta gjunjëzoni popullin trim shqiptar"...

Nuk pushojnë kërcënimet, fyerjet dhe agresioni i ish-regjimlinjve ndaj familjes, ndërsa njëri nga udbash-ët, xha Isakut dhe nënës, Shefkije, u drejtohet em këto fjalë:-" Këtu gjetëm Shqipërinë e Madhe dhe të Bashkuar me gjithë këtë literaturë, do t;ju kallim të gjithëve"... Por, nënëlokja, Shefkije, sypatrembur dhe pa aspak frikë ia ktheu ish- milicit në fytyrë:'- Ju qenki bër si çetnikët e Serbisë, po duaki ta zhdukni çdo shqiptar, kurrën e kurrës nuk do t'ia arrini, sepse shqiptari kurrë nuk dorëzohet dhe gjithmonë do të luftojë për atdhe dhe për Liri "... I goditur nga ky reagim trimëror i nënës, e cila kishte lindur, rritur dhe edukuar trima të vërtetë, ish-udbashi e godet me kondak pushke zonjën Shefkije, për t'u larguar kokëulur nga shtëpia e atdhetarëve të devotshëm... Ndërkohë, Nexhin e dërgojnë nëpër disa vende, si në Carallukë dhe në vendin, " Smonicë", në Tërpezë, aty ku atdhetarët tashmë kishin shkruar parullat e njohura të asaj pranvere, " Kosova Republikë"... Por, as këto burgosje, tortura, arres-

nuk Përëndon

time dhe dhunime nga pushtetarët sllavokomunistë nuk e ndalën asnjëherë Familjen e çmuar Krasniqi, e veçmas atdhetarin, Nexhmi Krasniqi, për të vazhduar veprimtarinë për të mirat e Kosovës dhe për çlirimin e atdheut tonë të robëruar... Me daljen e të Lavidshmes, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, të Pavdekshmes iu bashkuan menjëherë me organizimin dhe me veprim katër anëtarët e Familjes së Bacës, Isak , nga Tërpeza e krenarisë dhe atdhetarisë: Nexhmiu, Naxhiu, Elmiu dhe Mirdita... Mirdita, me nderim të thellë qepi dhjetëra uniforma për çlirimtarët e atdheut, të cilët, po luftonin maleve të Kosovës për çlirimin e Tokës SHQIPE nga robëria shoveniste shumëshekullore... Nexhmiu, si njëri nga themeltarët e Trimërores Shekullore dhe Mileniumiane, për shkak të guximit dhe veprimtarisë së tij atdhetare, personalisht dhe familjarisht, emërohet komandant i Policisë Ushtarake të UÇK-së në Zonën Operative të Pashtrikut, ku do të tubojë rreth vetes dhjetëra bashkëluftëtarë dhe do t'i trajnojë dhe përgatisë ata sa më profesionalisht, ushtarakisht, për ta luftuar dhe shporrur njëherë e përgjithmonë nga atdheu ynë armikun gjakatar pushtues serb.... Ai, jep kontribut organizimi, rritjeje dhe zhvillimi me ushtarët e tij edhe në njësitet dhe zonat e tjera të UÇK-së, si në Zonën Operative të Drenicës dhe Zonën Operative të Dukagjinit, duke mbajtur lidhje dhe komunikim të drejtpërdrejtë ushtarak dhe luftarak me komandantët e mirënjohur: Sylejman Selimi, Sami Lushtaku dhe Musa Jashari, me të cilët koordinojnë disa marshime dhe aksione çlirimtare luftimi... Por, Nexhi nuk i harron as bashkëluftëtarët e tjerë, si: Ilir Krasniqi, Besim Hoxha, Hajdar Hoxha, Reshat Balaj, e plot bashkëçlirimtarë të tjerë, me të cilët bashkëveproi, bashkëluftoi dhe kaloi kohë trimërie e lavdie... Edhe gjatë luftës së UÇK-së, por edhe sot në paqe, Nexhmi Krasniqi dëshmoi përherë : Guxim, Krenari, Unitet dhe Bashkëpunim të ndërsjellë me dhe për bashkëluftëtarët dhe bashkëçlirimtarët...

Në Familjen bujare e liridashëse të Isak, Nexhmi, Elmi, Naxhi dhe

Komandant Nexhmi Krasniqi-" Skifteri 500" me bashkëluftëtarin, Çerkin Dugolli. Lufta e UÇK-së, Qershor 1998, Luzhnicë

Mirdita Krasniqi, qëndruan, pushuan dhe u mirëpritën në rrethana tejet të vështira, heronjtë e atdheut: Ismet Jashari- " Kumanova", Tahir Sinani, Ymer Alushani (Vogëlushi) , profesor, Hamdi Berisha dhe shumë çlirimtarë të tjerë...

Në anën tjetër me krenari, përveç në UÇK, vëllai i Nexhmiut, Naxhiu, mori pjesë edhe në dy lavditë që lindën pas UÇK-së: Në UÇPMB dhe në UÇK në Maqedoni... Naxhi Krasniqi, në të tri luftërat njihej me emrin luftarak, "Kaçurreli" dhe po ashtu, ai la mbresa të thella në luftërat e lavdishme të fundshekullit XX dhe fillimit të Shekullit XXI në trojet shqiptare: Në Kosovë, Kosovë Lindore dhe në Maqedoni... Në Familjen bujare e liridashëse të Isak, Nexhmi, Elmi, Naxhi dhe Mirdita Krasniqi, qëndruan, pushuan dhe u mirëpritën në rrethana tejet të vështira, heronjtë e atdheut: Ismet Jashari- " Kumanova", Tahir Sinani, Ymer Alushani (Vogëlushi) , profesor, Hamdi Berisha dhe shumë çlirimtarë të tjerë... Veprimet atdhetare, e posaçërisht çlirimtare nga Familja e Isak Nexhmi Krasniqit nga Tërpeza i mbështetën pandalshëm edhe dy djemtë e tjerë nga gurbeti, Skënderi dhe Besimi, të cilët dhanë para bashkë me shumë bashkëveprimtarë për UÇK-në, në kuadër të Fondit të mirënjohur dhe thellësisht humanitar, " Vendlindja Thërret"... Sot, Nexhmi Krasniqi, edhe në detyrën e rëndësishme që kryen, drejtor i Policisë Rajonale në Prizren, ku përveç Prizrenit të lashtë dhe kryengritës ,përfshihen edhe : Suhareka, Malisheva, Rahoveci dhe Dragashi, gëzon respekt dhe mirëkuptim nga qindra dhe mijëra qytetarë të këtij rajoni të rëndësishëm të Republikës së Kosovës... Ai, pothuajse flet shumë pak për veprimtarinë e tij atdhetare, dje në luftë, e sot në paqe dhe në lirinë e Kosovës... Por, për komandantin emblematik dhe të suksesshëm, " Skifteri 500", flasin veprat, veprimet, krenaria dhe profesionalizmi i tij...Nexhi është në shërbim të qytetarëve, pa dallim moshe, profesioni, largësie gjeografike. apo etniteti... Këtë e ka trashëgim nga Familja e nderuar Krasniqi, nga prindërit: Isaku dhe Shefkija, nga vëllezërit

Heronjtë e një kohe që kurrë nuk Përëndon: Tre komandantë, të cilët të bashkuar sakrifikuan, luftuan dhe ndriçuan për t'ia sjellë lirinë Atdheut tonë Heroik: Nexhmi Krasniqi,- Ismet Jashari-Komandant Kumanova dhe Fatmir Limaj... Luzhnicë, Maj, Lufta e UÇK-së, viti 1998... Më 25 Gusht të vitit 1888, bie për të mos vdekur kurrë i Madhi dhe i Pavdekshmi, Komandant Kumanova- Ismet Jashari... Lavdi dhe Krenari e Përjetshme...

dhe të gjithë ata që punojnë për të mirën e vendit dhe të Atdheut... Të mirat dhe sukseset në jetë Nexhmi Krasniqi, i ka trashëgim nga e Lavdishmja, e Pavdekshmja dhe e Papërsëritshmja: Ushtria Çlirimtare e Kosovës, së cilës ai i shërbeu me Sakrificë, me Nder dhe me Përkushtim Dinjitoz... Paq Veç Mirësi, suksese dhe atdhedashuri të pandalshme, Ju dhe krejt Familja Krasniqi, i nderuari Komandant- njeri i vlerave të larta profesionale, njerëzore e humanitare, z. Nexhmi Krasniqi- " Skifteri 500"...

Komandant, Nexhmi KRASNIQI " Skifteri 500", në Luftën e Lavdishme të UÇK-së... Sot, drejtor i Plicisë Rajonale të Kosovës në Prizren

Autor: GAZMEND MORINA

SABOTAZHET · PËRHAPJE E VALËVE · MUZIKANTI ..... KISERI (shq.) · TË FIKËT · NORA ISTREFI · ZANORE · EPOKA E RE · HEROI NË FOTO 2 · SHKENCA QË STUDION MORALIN · MINDERI I ULËT (krah.) · PËREMËR PRONOR · KRIPË E ACIDIT NITRIK

LUMË NË SHQIPËRI · TENISTJA BELGE JUSTINE / GLOBAL ARBITRATION REVIEW

BAR PËR TË DALË JASHTË (shq.) · GATESA / BASHKËT.

AKTORI HOLLIVUDIAN ... STILLER (shq.) · NDESHJET / ANA RUSO

KRYEQYTETI I KANADASË · KËNGËTARI PORTORIKAN .... MARTIN / ISMET JASHARI · ROSTOCK / NJË LLOJ BUFI

VOZË E MADHE DRURI QË SHËRBEN PËR TË MBAJTUR DJATHË (shq.) · NOTË MUZIKORE / ZANORE · KAPËRDIJ / KOD I TELEFONIT MOBIL

INTENSITET, METËR; INDIUM · VIJË QË SHPIE UJIN NË MULLI · A · IDHULL / RAMADAN (perkdh.)

EPOKA E RE · HEROI NË FOTO 1 · ARKEOLOGU SHQIPTAR SKËNDER · GJUMI I THELLË (med.) / ARKA PREJ HEKURI KU RUHEN PARA · BASHKËT. / NIKEL, AZOT · ALBANOLOGIA .... DURHAM · PUSULLAT

TRADITË, ADET (sh.pashq.) · ISH FUTBOLLISTI ÇEK ... KOLLER (BORUSSIA DORTMUND) · ZANORE / KËNGËTARI AMERIKAN .... BROWN (shqip.)

BANOR I VIETNAMIT TË VJETËR · SHKRONJA TË NJËJTA · KASTRIOT TUSHA / VEPRIMTARI I SHQUAR ..... BEQIRI

PATRIOTI YNË PRISHTINA · NË ÇFARË MASE · ZANORE · JO I VJETËR / JETËSHKRIM

GRIMCOVA (bised.) · UGANDA, TANZANIA · SIENA / MALLKOJ · LLOJ PJEPRI I VERDHË

AKTORI YNË NASER ..... · BANORE E HERSHME E NJË KRAHINE

I MBUSHUR TËRËSISHT; I ..... · KUVENDI I KOSOVËS · HOUSING AGENCY JAMAICA · BASHKËT. / MARC ANTHONY

AJËR (ang.) · MITRUSH KUTELI / PARIM I QARTË E I PËRCAKTUAR MIRË · AMERICAN PUBLIC MEDIA · TEDI ALVES · SHKENCA QË STUDION MORALIN · TREVISO · BOTIMI · DIJETAR FETAR MYSLIMAN / TANI

BASHKËT. · TINKA KURTI / NJË STINË · BRINJËT E NJË TREKËNDËSHI / PËREMËR PRONOR · SHTET (huaj)

DËMTIM I NJË MEKANIZMI GJATË LËVIZJES · PËRFUNDIM NË SHAH / FILM I YNI "... ISHIN KATËR" · DRITËRO AGOLLI / FUTBOLLISTI DANIELE (MILAN)

ZAMBIA, ESTONIA · I PARI I XHAMISË (pashq.) / ISH FUTBOLLISTI ..... SHAQIRI · EMËR MASHKULLI MYSLIMAN / BASHKËT.

PASURITË E PATUNDSHME QË SILLNIN TË ARDHURA (vjet.) · FUTBOLLISTI ANGLEZ .... PARKER (TOTENHAM) / GJYMTYRË E TRUPIT · NGASËSI I "Formula 1" .... HAKINEN

ISH FUTBOLLISTI IGLI .... · ALFRED KAÇINARI / PJESËTAR I AONËVE · MBAJTJE E ANËS / TRAJNERI GJERMAN REHAGEL

INTER · DIREK I ÇATISË / SHKRONJA TË NJËJTA · "RODA" / RIADI, DAKARI · ISH SOLISTJ ANGLEZE WINEHOUSE (shqip.) / OSMAN XHAKA

EPOKA E RE · KAM NJOHURI PËR DIÇKA / ZANORE · QË KA TË BËJË ME ORATORINË / OSAKA

HEROI NË FOTO 3 · ZANORE

E jashtëzakonshme

Krijesë e çuditshme në Kinë

Një krijesë misterioze është parë në Kinë. Me trup peshku dhe me gojë krokodili, krijesa u pa në Parkun e Liqenit të Baiyunit, në Guangzhou. Kafsha e çuditshme ka shkaktuar panik te qytetarët dhe autoritetet kanë ndaluar notimin në Parkun e Liqenit.

FOTO E DITES

Marinsat amerikanë në një stërvitje në mot të ftohtë në Kaliforni. Fotografia është realizuar nga Jae C Hong. /AP/

E rrallë

Botswana lejon gjuetinë dhe ngrënien e mishit të elefantit

Botswana, shtëpia e më shumë se 130 mijë elefantëve, po shqyrton heqjen e ndalimit të gjuetisë për kafshët e mëdha, për të luftuar atë që qeveria thotë se është 'konflikti gjithnjë në rritje midis njerëzve dhe kafshëve të egra' dhe rekomandon që mishi të përdoret për ushqim. Disa ligjvënës pohojnë se numri i madh i gjitarëve të tillë është shumë i lartë dhe shkakton probleme për fermerët e vegjël.

BARSOLETA E DITËS

Një femër shkon te falltari, i cili i kërkoi 20 dollarë për t'ju përgjigjur vetëm në dy pyetje. Ajo pagoi paratë dhe e pyeti:
- A nuk është tepër shtrenjtë për vetëm dy pyetje?
- Po, tepër shtrenjtë është, iu përgjigj falltari. E cila ishte pyetja e dytë?

Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Në ora 16:00

"THE GRINCH" 3D,

I Animuar/Komedi/Familjar; 1 ore 30 min

Rolet: Benedict Cumberbatch, Rashida Jones, Kenan Thompson, Cameron Seely, Angela Lansbury, etj.

Regjia: Scott Mosier, Yarrow Cheney

Në ora 17:30

"THE NUTCRACKER AND THE FOUR REALMS" 3D

Aventure/Fantazi/Familjar; 1 ore 39 min

Rolet: Keira Knightley, Mackenzie Foy, Eugenio Derbez, Mathew Macfayden, Helen Mirren, Morgan Freeman, etj.

Regjia: Lasse Hallstrom, Joe Johnston

Në ora 19:30

"MORTAL ENGINES" 3D,

Komedi; 1 ore 51 min

Rolet: Hugo Weaving, Hera Hilmar, Robert Sheehan, Jihae, Ronan Raftery, Leila George, Patrick Malahide, Stephen Lang, etj.

Regjia: Christian Rivers

Në ora 22:00

"HUNTER KILLER",

Aksion/Aventure/Fantazi; 2 ore 08 min

Rolet: Gerard Butler, Gary Oldman, Common, Linda Cardellini, Toby Stephens, Michael Nyqvist, Caroline Goodall, etj.

Regjia: Donovan Marsh

Për informata dhe rezervime të biletave thirrni FALAS: 0800 22 222 dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

DASHI
Edhe pse gjatë ditës do të keni mjaft agjendë të ngarkuar, do të gjeni kohën dhe mundësinë për t'ju përkushtuar më të rinjve.

DEMI
Sot ndjenja e xhelozisë nuk po ju ndahet. Me kalimin e orëve do të kuptoni që çdo gjë ishte e kotë dhe partneri ka sy vetëm për ju.

BINJAKËT
Do të irritoheni me çdo gjë dhe me çdo situatë. Sidomos për ju që këtë ditë jeni në punë, gjërat do të shkojnë shumë keq.

GAFORRJA
Partneri dhe personat e dashur do të jenë pjesë e juaja gjatë gjithë ditës sot. Po mendoni për dhuratat dhe surprizat që do t'ju bëni atyre që kanë ditëlindje.

LUANI
Edhe pse sot nuk ndiheni mirë nga gjendja shëndetësore, do t'ju duhet të mbyllni disa gjëra të rëndësishme që i kishit lënë për në moment të fundit.

VIRGJËRESHA
Do të keni debate të ashpra me një ortak në biznes. Muaji që po vjen nuk do t'ju gjejë mirë nga ana financiare.

PESHORJA
Tensioni i ditëve të fundit ju ka kapur edhe juve. Çdo gjë bëhet me vrap dhe në rrëmujë e sipër. Mund të harroni një mik pa e telefonuar.

AKREPI
Punët, humori dhe dashuria sot janë në ekuilibër të plotë. Një ditë e mbushur me momente gëzimi dhe qetësie që do ta shijoni në çdo çast.

SHIGJETARI
Nuk duhet që më të mëdhenjve në moshë t'ju vini re çdo gjë që thonë sot. Sa më tolerantë të jeni aq më shumë do ta shijoni ditën.

BRICJAPI
Dita e sotme karakterizohet nga tone të larta humori dhe ju do të jeni në mes të një ambienti që e njihni mirë.

UJORI
Po mendoni që situata në të cilën ndodheni mund të ishte më e mirë, por ju kënaqeni edhe me pak, kështu që do të shijoni çdo moment të ditës.

PESHQIT
Një dëshirë e madhe për të mos bërë asgjë dhe për të ndenjur të qetë. Ide brilante në mendje se si do ta nisni ditën dhe si do vazhdoni më tej.

Sport

QENDRA SPORTIVE
"BUJQËSIA"
TEL: 045/82 82 82

PROGNOZA SPORTIVE	LEIPZIG - HOFFENHEIM	1	MARITIMO - SPORTING	2	BESIKTAS - FENERBAHCE	3+

Feronikeli tregon forcën ndaj Llapit, Prishtina u rikthehet fitoreve

EPOKA E RE Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 24 SHKURT - Janë zhvilluar edhe ndeshjet e javës së 19 në IPKO Superligë, kurse derbin e ka fituar skuadra e Feronikelit ndaj Llapit. Fitoreve u është rikthyer edhe skuadra e Prishtinës që e mposhti në stadiumin "Fadil Vokrri" skuadrën e Lirisë, kurse Trepça '89 e mposhti kampionen aktuale të elitës, Dritën. Të shtunën fitoreve u janë gëzuar edhe Ballkani dhe Drenica, kurse ndeshja në mes të Gjilanit dhe Flamurtarit përfundoi 0-0.

Feronikeli - Llapi 2-0

Feronikeli vazhdon formën e mirë në sezonin pranveror, duke e regjistruar edhe fitoren e tretë. Në fakt, skuadra nga Drenasi dy fitore i ka në ligë dhe një në Kupë.
Sot në derbin ndaj skuadrës së Llapit, Feronikeli arriti fitore me rezultat 2-0. Golin e parë në këtë ndeshje e shënoi Mendurim Hoti në minutën e 30, ndërsa rezultatin final 2-0 e vulosi Astrit Fazliu, i cili shënoi në fund të takimit. Pas kësaj xhiroje "Nikli" vazhdon të jetë lider në elitë me 45 pikë, kurse Llapi bën një hap pas në garën për titull dhe tash mbetet shtatë pikë prapa skuadrës lidere.

Prishtina - Liria 4-0

Skuadra e Prishtinës pas eliminimit nga Kupa dhe humbjes në javën e parë të sezonit pranveror nga Flamurtari në Superligë, të dielën është këndellur dhe ka shënuar fitore bindëse ndaj Lirisë (4-0). Serinë e golave për kryeqytetasit në ndeshjen e zhvilluar në stadiumin "Fadil Vokrri" e hapi pas dy minutave lojë, Gauthie Mankenda. Në pjesën e dytë, vendësit ishin edhe më të rrezikshëm dhe si rezultat i saj realizuan edhe tre gola të tjerë nëpërmjet Thaqit, Korenicës dhe Hoxhës. Prishtina tash ka dy pikë më pak se Feronikeli dhe pesë më shumë se Llapi. Në xhiron e radhës Prishtina i shkon Llapit, kurse Liria e pret skuadrën e Gjilanit.

Trepça '89 - Drita 1-0

Kampionia aktuale e Kosovës në futboll, Drita, pas fitores në javën e kaluar në derbi ndaj Gjilanit (3-1), në xhiron e dytë të sezonit pranveror ka pësuar humbje nga skuadra e Trepçës '89 (1-0). Golin e vetëm në ndeshjen e zhvilluar në Mitrovicë e ka shënuar Hasan Hyseni në minutën e 14. Skuadra nga Gjilani u mundua me të gjitha forcat të dalë e pamposhtur nga kjo ndeshje, por nuk ia arriti qëllimit dhe ndeshja përfundoi me rezultat 1-0. Në xhiron e ardhshme '89-shi i shkon Flamurtarit në kryeqytet, kurse Drita e pret Drenicën.

Fitojnë Drenica dhe Ballkani, Gjilani dhe Flamurtari ndajnë pikët

Tri ndeshjet e tjera të kësaj xhiro janë zhvilluar të shtunën. Drenica ka shënuar fitore në stadiumin "Bajram Aliu" në Skenderaj në duel me Ferizajn, me rezultat 3-1. Golat për vendësit i shënuan Kreshnik Uka (5'), Diar Prokshi (29') dhe Qemail Elshani (82'), kurse golin e vetëm për ferizajasit e shënoi Genc Hamiti (84'). Fitore si vendas ka shënuar edhe Ballkani që pa ndonjë problem e mposhti skuadrën e KEK-ut, me rezultat 3-0. Golashënues ishin Blend Baftiu (27'), Borche Manevski (62') dhe Besnik Krasniqi (90'). Flamurtari pas fitores ndaj Prishtinës e ka marrë edhe një rezultat të mirë. Kuqezinjtë nga kryeqyteti luajtën baras ndaj Gjilanit (0-0).

IPKO SUPERLIGA

Feronikeli - Llapi	2-0
Trepça '89 - Drita	1-0
Prishtina - Liria	3-0
Drenica - Ferizaj	3-1
Gjilani - Flamurtari	0-0
Ballkani - KEK-u	3-0

TABELA

1. Feronikeli	19	45 pikë
2. Prishtina	19	43
3. Llapi	19	38
4. Gjilani	19	28
5. Drenica	19	27
6. Ballkani	19	27
7. Drita	19	26
8. Flamurtari	19	26
9. Trepça '89	19	25
10. Liria	19	19
11. Ferizaj	19	18
12. KEK-u	19	1

Në xhiron e radhës takohen: Ferizaj-Ballkani, KEK-u-Feronikeli, Drita-Drenica, Llapi-Prishtina, Liria-Gjilani, Flamurtari-Trepça '89.

LIGA E PARË

Onix - Drenasi	0-0
Vëllaznimi - 2 Korriku	2-0
Arbëria - Vushtrria	0-1
Kika - Bashkimi	1-1
Vllaznia - Istogu	2-0
Vitia - Besa	2-0
Ramiz Sadiku - Dukagjini	0-2

Të hënën takohen:
Trepça - Fushë-Kosova

TABELA

1. Vushtrria	17	41 pikë
2. Dukagjini	17	36
3. Besa	17	35
4. Vitia	17	34
5. Vëllaznimi	17	32
6. Onix	17	27
7. Arbëria	17	25
8. Trepça	16	24
9. Istogu	17	20
10. Drenasi	17	19
11. 2 Korriku	17	18
12. Kika	17	16
13. Ramiz Sadiku	17	15
14. Fushë Kosova	16	14
15. Vllaznia	17	11
16. Bashkimi (K)	17	10

SHKURT

Zeneli shënon golin e parë në Francë

Futbollisti i Përfaqësueses së Kosovës, Arbër Zeneli, ka realizuar golin e parë te skuadra franceze Reims. Golin e parë në fanellën e skuadrës franceze Zeneli e realizoi në xhiron e 26 të Ligës 1 kundër Montpellierit. Fillimisht ai asistoi për Oudinin në minutën e 27, për ta barazuar rezultatin, ndërsa në minutën e 47 mori përgjegjësinë për të gjuajtur nga penaltia dhe për ta çuar në epërsi skuadrën e tij, 1 me 2. Ndeshja përfundoi me rezultat 2-4.

Kasami shënon dy gola, Lenjani asiston

Sioni ka barazuar me rezultat 2-2 ndaj St Gallenit në ndeshjen e vlefshme për javën e 22-të të kampionatit zviceran, kurse ka shkëlqyer futbollisti shqiptar Pajtim Kasami. Mesfushori ka realizuar dy gola në këtë ndeshje për skuadrën e tij, kurse duhet cekur se në njërin gol ai është shërbyer nga shqiptari tjetër, Ermir Lenjani.

Mehmedi, dy gola për Wolfsburgun

Wolfsburgu e mposhti si mysafir Borussia Monchengladbach me rezultat 0-3, kurse në këtë ndeshje ka shkëlqyer futbollisti shqiptar Admir Mehmedi. Reprezentuesi i Zvicrës ka shënuar dy gola në këtë ndeshje, kurse në pjesën e dytë për mysafirët luajti edhe shqiptari tjetër Elvis Rexhbecaj.

Ajeti shënon golin e parë me Grasshoppersin

Mbrojtësi i kombëtares shqiptare, Arlind Ajeti, ka shënuar golin e parë për Grasshopperin në Zvicër. Qendërmbrojtësi shqiptar ka realizuar golin e barazimit për ekipin e tij në takimin kundër Thunit. Ky është goli i parë i Ajetit me fanellën e Grasshopperit në Zvicër, ndërsa gjatë gjithë karrierës qendërmbrojtësi kuqezi ka shënuar edhe pesë gola të tjerë në të gjitha kompeticionet.

Unitedi dhe Liverpooli ndahen në 'paqe'

MANCHESTER, 24 SHKURT - Derbi i zhvilluar në "Old Trafford" në mes të Liverpoolit dhe Manchester Unitedit nuk ka sjellë fitues pasi ndeshja përfundoi 0-0. Ky rezultat i ka shërbyer më shumë skuadrës së Jurgen Kloppit që ka rimarrë kryesimin e kampionatit, edhe pse avantazhi ndaj Manchester Cityt të vendit të dytë është vetëm një pikë. Unitedi, nga ana tjetër, ka zbritur në vendin e pestë. Tifozët e Unitedit kanë festuar në minutën e 75-të për një autogol të Joel Matip, por që është anuluar nga gjyqtari për pozicion jashtë loje të Luke Shawit. Kloppi nuk ka qenë i kënaqur me barazimin dhe në minutën e 72-të ka aktivizuar Xherdan Shaqirin, mesfushor sulmues, në vend të Jordan Hendersonit, mesfushor mbrojtës, me këtë të fundit që nuk ka qenë i kënaqur me lëvizjen dhe ka debatuar me trajnerin pasi ka dalë nga fusha.

Besa fiton derbin ndaj Prishtinës në 'Karagaçi'

Pejë, 24 shkurt - Kampionia aktuale e Kosovës në hendboll, Besa Famgas, është kthyer te fitorja të shtunën në mbrëmje, kur në palestrën "Karagaçi" në Pejë e mposhti Prishtinën me rezultat bindës 33-19. Ishte kjo kryendeshja e xhiros së 17 të Superligës së Kosovës për hendbollistë. Besa javën e kaluar pësoi humbje nga Kastrioti në Ferizaj, por kësaj radhe skuadra pejane dështmoi potencialin e madh që ka dhe arriti fitore. Pas pjesës së parë rezultati ishte 17-7 në të mirë të ekipit pejan. Prishtina në vjeshtë kishte mposhtur Besën, por këtë herë pësoi humbje me rezultat të lartë. Besa Famgas tani i ka 30 pikë dhe është ngritur në vend të parë. Besën drejt fitores e udhëhoqi Gjuka me 10 gola, kurse te Prishtina më efikasi ishte Kastrati me 4 gola.

'Euronews': Turri i Majlindës drejt majave vazhdon

Prishtinë, 24 shkurt - "Euronews" e ka lartësuar xhudisten nga Kosova, Majlinda Kelmendi, në një shkrim kushtuar Grand Slamit të Xhudos në Dusseldorf të Gjermanisë, duke thënë se ky është rikthimi i kampiones olimpike. Në ditën e parë heroina kosovare, Majlinda Kelmendi, shkruan "Euronews", e vazhdoi turrin e saj drejt majave në kategorinë - 52 kilogramë, pasi e fitoi titullin e gjashtë Grand Slam në karrierën e saj. "Kampionia olimpike u ka treguar të gjithëve se kjo kategori i përket asaj dhe ky është rikthimi i saj. Sulm pas sulmi nga ajo nënkupton se ajo është Gruaja e Ditës e zgjedhur nga ne", shkruan "Euronews".

Në rrugë drejt medaljes së artë, Majlinda e mposhti Verena Thumm të Gjermanisë, Odette Giuffrida të Italisë në gjysmëfinale dhe Sosorbaram Lkhagvasuren e Monglisë në finale. Kjo nënkupton se Majlinda e ka tani në cak titullin e botës në fund të këtij viti.

Houstoni, 'leksion' kampionëve të Golden States, humbasin Lakersi dhe Oklahoma

Oakland, 24 shkurt - Houstoni korri fitore ndaj Golden States në fushën e këtij të fundit me rezultat 118-112. Ekipi teksan e komandoi gjatë gjithë kohës ndeshjen, duke e merituar fitoren. Sukses që erdhi pa praninë e Hardenit, ndërkohë që u dalluan Gordoni me 25 pikë dhe Pauli me 23 pikë e 17 asistime. Për Warriorsin, Duranti realizoi 29 pikë e Curry 25, por që s'mjaftuan për ta evituar humbjen. Humbet edhe Boston Celticsi, që u mund 126-116 nga Chicago. Miqtë dominuan vetëm në periodën e parë, pasi më tej ishin basketbollistët e Bullsit ata që komanduan në fushë, me LaVine që realizoi 42 pikë. Ngecin sërish lakersat, që u mundën 128-115 nga New Orleansi, humbje që ndërlikon pozitat e kalifornianëve për një vend në "play-off". Holiday me 27 pikë e Randle me 24 bënë diferencën në parket për vendësit, duke i bërë të pavlefshme 27 pikë e 12 asistime për kalifornianët. Ka zhgënjyer edhe Oklahoma, që në fushën e vet u mund 119-116 nga Sacramento,

ndeshje me rivalitet në minutat e fundit të saj. Westbrooku realizoi 41 pikë e 10 rebounde, por që mbetën për statistikë, ndërsa për miqtë u dallua Hieldi me 34 pikë. Surprizë edhe humbja e Philadelphias, që u mund 130-115 nga Portlandi, ndeshje e vendosur në pjesën e dytë (NurkiQ 24 pikë e 10 rebounde). Milwaukee bën detyrë, duke mundur 140-128 Minnesota, falë 28 pikëve të Middletonit dhe 27 të Giannisit.

REZULTATET

Philadelphia - Portland	115-130
Atlanta - Phoenix	120-112
Charlotte - Brooklyn	115-117
Cleveland - Memphis	112-107
New Orleans - Lakers	128-115
Washington - Indiana	112-119
Miami - Detroit	96-119
Chicago - Boston	126-116
Oklahoma - Sacramento	116-119
Golden State - Houston	112-118
Milwaukee - Minnesota	140-128
Utah Jazz - Dallas	125-109

SHKURT

Mbappe thyen rekordin 37-vjeçar

Dy golat ndaj Nimes i shërbyen Kilian Mbappes për ta arritur kuotën e 50 golave në "Ligën 1". Sulmuesi i PSG-së vendos kështu një rekord të ri, duke e arritur këtë kuotë golash më shpejt se kushdo tjetër më parë në moshën 20 vjeç e dy muaj dhe tre ditë. Vendin e dytë Janik Stopira e ka arritur këtë në moshën 21 vjeç e 11 muaj e nëntë ditë, pra një diferencë prej më shumë se një viti e gjysmë. Goli i parë i Mbappesë në kampionatin francez ka qenë më 20 shkurt të 2016-s, kur sulmuesi kishte pak muaj që kishte mbushur 17 vjeç. Aktualisht Mbappe po zhvillon sezonin e tij më të mirë në karrierë teksa thyen rekordin personal prej 15 golash dhe është në shifrën e 23 finalizimeve kur ka ende edhe 13 ndeshje deri në përfundim të kampionatit.

Mediet në Gjermani lavdërojnë Abrashin

Amir Abrashi ishte sërish titullar pasditen e djeshme në fitoren spektakolare të Freiburgut kundër Augsburgut. Një ndeshje që dhuroi shumë emocione ditën e djeshme në Bundesliga, pasi skuadra e mesfushorit shqiptar shënoi pesë herë në portën kundërshtare, duke dalë në fund me vetëm një gol të pësuar, ndërsa koleksionon edhe tri pikë të rëndësishme. Ashtu si në ndeshjen e parë, Amir Abrashi luajti titullar dhe e përfundoi deri në fund takimin, duke bërë një tjetër paraqitje bindëse me ekipin e tij.
"Pitbulli", siç e thërrasin ndryshe, arriti të ishte deciziv në thyerjen e aksioneve kundërshtare, madje duke i vënë të gjithë rivalët në vështirësi. Është portali "Sudukurier", që bën analizën për çdo lojtar të Freiburgut në ndeshjen e djeshme, duke dhënë edhe vlerësimet përkatëse. "Ai vrapoi disa herë më shpejt se kundërshtarët, kontrollonte topin dhe më pas qarkullonte", shkruan ky portal në analizën për futbollistin e kombëtares shqiptare. Më pas vijon duke shkruar: "Futbollisti ndërkombëtar i Shqipërisë ishte thjesht shumë më i fortë se të gjithë lojtarët e Augsburgut që erdhën sot për të luajtur. Një galaktik i shkëlqyer, i cili mori një vlerësim të merituar nga trajneri. Abrashi e ka bërë Christian Streich të lumtur dhe të gjithë tifozët e Freiburgut. Ai meriton një njësh me yll", ka shkruar sajti gjerman.

Messi: Tash fitojmë edhe ndaj Realit

Lionel Messi ishte autori i një ndeshjeje spektakolare me Sevillen, fitoren e së cilës e konsideron një hap të madh drejt titullit kampion. "Ka shumë ndeshje në kampionat, por ishte e rëndësishme të fitonim këtu për ta ruajtur distancën me kundërshtarët. Është e vërtetë se kjo sfidë vlen sa gjysma e kampionatit. Tani vijnë takimet e vështira dhe nuk janë të lehta për t'u fituar. Me Sevillen kemi pasur gjithmonë probleme", ka thënë Messi. Kapiteni i katalanasve foli edhe për "El Clasico"-t. "Nuk dorëzohemi në asnjë kompeticion. Jemi shumë pranë kualifikimit për në finalen e Kupës së Mbretit. E dimë se do të jetë e vështirë ndaj një rivali si Reali dhe për më tepër në fushën e tij. Por, do të shkojmë për të fituar dhe besojmë se mund t'ia dalim. Pastaj të mendojmë për kampionatin dhe Ligën e Kampionëve. Duam të fitojmë gjithçka këtë vit", ka deklaruar Messi.

Leicesteri shkarkon trajnerin

Skuadra e Leicester Cityt e ka shkarkuar trajnerin Claude Pauel. Ky shkarkim erdhi pas humbjes që pësoi Leicester City ndaj Crystal Palaces (1-4). 57-vjeçari largohet duke e lënë klubin në vendin e 12-të në Premierligë, pasi i ka humbur pesë nga gjashtë ndeshjet e fundit në ligë. Francezi e udhëhoqi ish-kampionin e Premierligës drejt vendit të nëntë në sezonin e tij të parë si trajner, por tani klubi është në kërkim të trajnerit të katërt brenda 23 muajve.

AUTOSHKOLLA
"RITMO – L"



Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë

Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.

Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "
Tel / kontakt:
044 248 173
044 200 604
044 375 333

ODA E MJEKËVE TË KOSOVËS
KOSOVO DOCTORS CHAMBER • LEKARSKA KOMORA KOSOVA

Oda e Mjekëve të Kosovës – Kosovo Doctors Chamber – Lekarska Komora Kosova

FTESË PËR OFERTË

Lloji i Kontratës: ☒ Furnizim ☐ Shërbime ☐ Punë

Nr. i Prokurimit 03-19

Oda e Mjekëve të Kosovës është organizatë e pavarur profesionale e mjekëve që ushtron veprimtari profesionale mjekësore në Republikën e Kosovës.

OMK anëtareve të saj, i siguron standarde të larta të kodit të etikës dhe deontologjisë mjekësore, promovon dhe mbron veprimtarinë e profesionistëve shëndetësor në institucionet shëndetësore publike, private si dhe publiko-private, siguron edukimin e vazhdushëm profesional me qëllim të ngritjes së performancës shëndetësore dhe ofrimit më cilësor të shërbimeve shëndetësore dhe shërbimeve tjera që kanë të bëjnë me kujdesin shëndetësor.

Oda e Mjekëve të Kosovës fton të gjitha kompanitë e interesuara që të paraqesin kërkesën e tyre për dosje të tenderit në **adresën Instituti A, Kati 2, QKUK, 10000 Prishtinë, apo përms emailit: info@omk-rks.org, me titullin:**
Dosja për: **Kontrat për Furnizim me mobile për nevojat e zyrës të OMK-së**

Në pajtim me Nenin 8, paragrafin 1 të Rregullores për Procedurat e Prokurimit në OMK:

☐ Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratat me vlerë të madhe (që tejkalojnë shumën prej 10,000.00 €).

☒ Afati për parashtrimin e ofertave është në kohëzgjatje prej 10 (dhjetë) ditëve nga dita e publikimit, për Kontratat me vlerë të mesme (**vlera e të cilave është deri në 10,000.00 €**).

Njoftimin për kontratë mund ta shkarkoni në ueb-in e Odës: https://omk-rks.org/

Afatet Kohore.

Afati i fundit për tërheqje të dosjes së Tenderit është: **01.03.2019 ora 14:00.**
Afati i fundit për aplikim në Tender është: **03.03.2019 ora 14:00.**
Hapja e ofertave bëhet me datën: **08.03.2019 ora 14:00.**

Drejtoria e Gjimnazit "Remzi Ademaj" në Prizren
Nr.prot: 68/2019 datë 25.02.2019
Prizren

Bazuar në nenin 11, të Udhëzimit Administrativ –Aktivitetet jashtëshkollore nr. 02/2016 të dt. 12.01.2016, dhe në vendimin nr. Prot: 48/2019 të datës 14.02.2019, të KDSH, - Gjimnazi "Remzi Ademaj" në Prizren, shpall:

Ftesë për ofertë

Për ekskursion të maturantëve të gjimnazit "Remzi Ademaj" në Prizren

Ftojmë ofertuesit e kualifikuar (Agjencitë turistike organizatore të udhëtimit) që të paraqesin ofertat e tyre në zarf të mbyllur, për ekskursionin e maturantëve të Gjimnazit "Remzi Ademaj" nga Prizreni për në Republikën e Shqipërisë më datën 27.04.2019 deri më 02.05.2019.
Paraqitësit në tender duhet t'i plotësojnë këto kushte:

Kriteret e përgjithshme:

- **Certifikatën e biznesit me informata për bisnesin,**
- **Vërtetim për pagesën e taksave komunale për vitin 2018 në origjinale**
- **Vërtetimin e Administratës Tatimore që nuk ka borxhe për vitin 2018 në origjinale**
- **Referencat rreth organizmit të ekskursioneve me maturantë për tri vitet e fundit 2016, 2017, 2018.**
- **Fotokopjet e librezave të autobusëve që janë të regjistruar sipas procedurave ligjore dhe kontrollit teknik**
- **Certifikata e autobusit sipas licencës**
- **Licencën e transportit ndërkomëtar ''D''**
- **Kopjen e sigurimit të autobusëve, patentshoferëve të vozitësve dhe certifikata e kopetences profesionale CPC**
- **Autobusët të jenë komforë me klimë dhe në numër të mjaftueshëm për mbi 350 vende**
- **Certifikatat mjekësore për vozitësit**
- **Kompania të sigurojë mjekun (certifikatë pune, diplomë të mjekut dhe kontratën me mjekun)**
- **Licencën e agjensionit të akreditimeve të ushqimeve në vendqëndrimin e nxënësve**
- **Dëshmi për konfirmimin e rezervimit të Hotelit për datën 27.04.2019 deri më 02.05.2019.**
- **Të prezentohet ambienti (komoditeti) së paku me foto i Hotelit nr.telefonit i pronarit dhe adresa të përcaktuar nga KDSH.**
- **Hoteli të posedojë mbi 390 shtretër. Të posedojë rrethojë dhe i siguruar nga personeli i sigurimit të hotelit për të garantuar siguri për nxënës përcaktuar nga KDSH.**
- **Hoteli të posedojë sallën e ushqimit me hapsirë të mjaftueshme mbi 350 vende për ushqim në tri vaket kriter i përcaktuar nga KDSH.**
- **Hoteli të posedojë sallë për argëtim së paku për 350 nxënës dhe të mos shërbehen pije alkoolike për nxënës kriter i KDSH.**
- **Licencen e sallës së argëtimit për së paku 350 veta përcaktuar nga KDSH.**
- **Sistemimi i nxënësve në dhoma të jetë jo më shumë se katër nxënës përcaktuar nga KDSH.**
- **Gjatë vizitave nëpër monumente pagesa për nxënës të sigurohet nga kompania kriter i KDSH.**
- **Agjencioni duhet të ofrojë listën e shoferëve dhe punëtorëve që do të marrin pjesë në eksursion.**
- **Agjencioni të ofrojë dëshmi për qarkullimin financiar nga banka për tre vitet e fundit (2016, 2017, 2018).**
- **Agjencioni duhet të ofrojë një listë me emrat e shoferëve që do të marrin pjesë në eksursion, kategorin e patent shoferit, llojin e autobusit, vitin e prodhimit, numrin e ulësve dhe targat e autobusit që do të vozisin.**
- **Agjencioni duhet të ofrojë listen e shoferëve dhe punëtorëve të deklaruar në ATK që do të marrin pjesë në eskursion;**
- **PS. Kopjet e dokumenteve duhet të jenë të noterizuara;**

Ofertuesit e interesuar aplikacionet dhe itinerarin e udhëtimeve mund t'i marrin në administratën e shkollës dhe të kompletuara me dokumentacionin e kërkuar të dorëzohen në Drejtorinë e Arsimit në Prizren.
Afati i paraqitjes në tender është 7 ditë nga dita e publikimit në gazetë.
Hapja e ofertave bëhet nga komisioni sipas UA 02/2016 me datë 04.03.2019.
Pas hapjes se ofertave, Komisioni do të verifikojë dokumentacionin dhe kushtet e ofruara nga kopmanitë, ku dhe do të bëhet vlerësimi.
Fituesi i ofertës për organizimin e ekskursionit do të jetë kompania Turistike e përgjegjëshme më çmimin më të ulët të ofertës.
Drejtoria e shkollës mban të drejtën për anulimin e ofertës.



>> SHPALLJE TË VOGLA <<

▶ D.P.Z. Auto Servis "Te Ridvani" shpallë të pavlefshme certifikatën e biznesit me nr: 70474909.

▶ Albiodren Bytyqi shpall te pavlefshme dëftesat dhe diplomën Gymnazium Loyola Prizren.

▶ Gjynejt Kallo shpall te pavlefshme dëftesat e kl, VI - IX SHF "Mustafa Bakiu" Prizren.

▶ Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

▶ Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

▶ Shitet banesa në Lakërishte përballë Procredit Bankës, hyrja e parë kati i 9 banesa ka 50m2 me dokumentacion të rregullt, çmimi52 000€. Për info 044/672-439.

▶ Lëshohet me qira banesa në lakërishte afër Procredit bankës është e mobiluar 50m2 për një çift çmimi është 220€. Për irno 044/672-439.

▶ Shes banesën hyrja e 7 mbi kurriz te banesat e gjelbërta përball shkollës "Xhemajl Mustafa" e rinovuar tërësisht. Banesa ka 82 metra katror. 3 dhoma, sallon, shpajz dhe ballkon + taras me shfrytëzim. Çmimi 75000 Euro me para te gatshme, por bej edhe ndërrim me banesë me të vogël në Prishtinë ose banesë më të madhe në Fushë Kosovë sipas marrëveshjes. Numri kontaktues: 044 672 439

▶ Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

▶ Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

▶ Kërkoj kamerier me përvojë pune. Gjendemi në Prishtinë te sheshi "Zahir Pajaziti". Nr: kontaktues- 045-999-985.

▶ Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.

▶ Lëshohet banesa me qira kati i parë , në rr. Esat Mekuli, çmimi i volitshëm. Për info. 044/ 477-107 Prishtinë. Çmimi shumë i volitshëm dhe është e mobiluar komplet.

▶ Lëshohet banesa me qira ne qendër të Prishtinës afër Sheshit Zahir Pajaziti, banesa është dy dhomshe e mobiluar, lëshohet me qira prej 1 qershori deri me 1 gusht (dy muaj), çmimi sipas marrëveshjes. Për informata në tel. 044/171-328.]

▶ Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes , sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

MEKA
HALAL FOOD
pashtetë pule
gluten free
100 % mish pule
cilësi e garantuar
pa konservues

ROYAL CROWN;
RC cola
ANNOUNCING THE 2017
QUALITY & SALES AWARDS
Quality & Sales Award Recipients
[Listed in alphabetical order]
★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo Philippines, Quality
★ Embotelladaora Central S.A Paraguay, Quality
★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. Guatemala, Qualtiy
★ Fluidi Sh.p.k. Kosovo, Quality
★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda Brazil, Quality
★ Interbrand S.A.L. Lebanon, Sales
★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. Czech Republic, Quality
★ Obi Zulol CJSC Tajikistan, Quality
★ Partex Sales sales Beverages Ltd. Bangladesh, Quality
★ Soft Drinks Georgia Georgia, Sales
RC cola
Columbus, Georgia, USA
Since 1905
0.5L